Detyrimet afatshkurtra të qirasë	367,833
Detyrimet afatgjatë të qirasë	2,432,385
	2,800,218

Shuma te njohura ne te ardhura e shpenzime

Shpenzime amortizimi te aktiveve me te drejta ne perdorim	274,942
hpenzimet e zhvlerësimit për të drejtën e nënligjshme të përdorimit, të paraqitura në pronat e Investimit	30,140
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	115,964
Shpenzimet që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët, të cilat nuk paraqiten më lart si qira afatshkurtra	995
Shpenzimi në lidhje me pagesat e qirasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë	7,841
	429,882

17. PROVIZIONET

Lëvizjet e provizioneve për rreziqe paraqiten si vijon:

Afatshkurtër:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja më 1 janar	-	35,765
Transferim ne Provisione afatshkurtra	55,263	(35,765)
Gjendja më 31 dhjetor	55,263	-

Afatgjatë:	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja më 1 janar	104,646	304,163
Transferim nga Provisione afatgjata	(55,263)	35,765
Shtesa provizione	-	44,305
Rimarrje për vitin	-	(279,587)
Gjendja më 31 dhjetor	49,383	104,646

18. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare ndahen në afatshkurtra dhe afatgjata si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme tregtare afatgjata	315,175	581,117
Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra	3,146,890	2,728,904
	3,462,065	3,310,021

18. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme detajohen më tej:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Qeveria Shqiptare	663,647	-
Bayerische Landesbank	423,033	536,489
MAKHES ALBANIA	310,532	299,847
Hua Ying Management Co. Limite	267,326	304,705
Telecom Italia Sparkle S.p.A	200,139	290
Plus Communication Sh.a	152,858	293,957
OKTAPUS shpk	141,308	101,491
GOGEL shpk	140,180	178,264
CALIK HOLDING A.S	92,562	223,652
Posta Shqiptare -Tirane	87,358	128,140
Furnitore te tjere	983,122	1,243,186
	3,462,065	3,310,021

19. GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA

Grantet përfaqësojnë pajisje telekomunikacioni ndërsa të ardhurat e shtyra për kohë të pakonsumuar përfaqësojnë kohë bisede të pakonsumuar të kartave rimbushëse të shitura në fund të vitit.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Grante	91,361	114,801
Të ardhura të shtyra për kohë të pakonsumuar	61,793	69,139
Të ardhura të shtyra nga kontrata me klientet	201,844	217,917
	354,998	401,857

20. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME

Detyrimet të tjera afatshkurtra të shoqërisë janë të analizuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Personeli	129	86
Sigurime shoqërore	17,777	17,488
Shteti tatime e taksa	95,721	100,357
Të tjera detyrime	40,099	38,813
	153,726	156,744

20. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME(vazhdim)

Detyrimet ndaj punonjësve

Marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë me punonjësit e tyre bazohen në kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata kolektive e punës është lidhur ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj për përcaktimin e detyrimeve reciproke që lindin nga marrëdhënia e punës.
Sipas legjislacionit të punës në fuqi, shoqëria mund të penalizohet deri në 15 paga mujore në rast të një ndërpreje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të marrëdhënies së punës me punonjësin e saj.
Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë provizion lidhur me kostot e mundshme nga ndërprerja e menjëhershme dhe e pa justifikuar e kontratave të punës me punonjësit e saj.

Numri mesatar i personelit sipas funksioneve është si vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Drejtorë, Manaxherë e drejtues departementi	103	103
Specialistë	646	645
Personel teknik	45	41
Punëtorë	15	15
Stafi ndihmës	5	5
	814	809

Shteti tatim e taksa

Shteti tatim e taksa analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH për t'u paguar	65,003	41,944
Tatim mbi të ardhurat personale	9,948	12,396
Tatimi në burim	20,770	46,017
	95,721	100,357

21. SHITJET NETO

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Shërbimi telefonik kombëtar fix	2,754,165	2,717,934
Shërbimi telefonik kombëtar mobile	2,634,709	2,442,333
Shërb. telefonik ndërkombetar	731,937	860,794
Shërbimi Roaming	93,611	168,097
Shërbimi interkoneksionit ndaj operatorëve	773,205	985,173
Internet, ADSL, ISDN, LAN,internet IP	584,650	628,182
Shërbimet e instalimit	34,529	31,736
Linjat dhe qarqet me qera	103,008	99,914
Të ardhura të tjera	2,948	2,221
Shërbimi i kartës së parapaguar	242	283
Total të ardhura nga veprimtaria kryesore	7,713,004	7,936,667
Nga modem dhe ADSL, Sim Card dhe të tjera	39,838	47,864
Shitje aparati telefonik	16,219	44,773
Ifrs 15 adjustment	(10,940)	14,826
Aksesorë	345	267
Total shitje Malli	45,462	107,730
Të ardhura nga qiraja	81,123	73,581
Të ardhura nga sherbime per fix	3,289	3,151
Të tjera	19,715	13,206
Total të ardhura të tjera	104,127	89,938
Total shitje neto	7,862,593	8,134,336

22. SHPENZIMET

Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e ndara sipas natyrës dhe funksionit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018.

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019			
	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile Telekom Albania	271,477	-	-	271,477
Operatorët Mobile Vodafon	453,416	-	-	453,416
Operatorët Rurale/alternativë	19,337	-	-	19,337
Operatorë të tjerë (vas)	1,082	-	-	1,082
Operatorët Ndërkombëtarë	539,477	-	-	539,477
Shpenzime Interneti	104,518	-	-	104,518
Licensa	190,779	-	-	190,779
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	17,388	18,171	35,559
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	602,843	1,207	65,221	669,271
Shpenzime Qeraje	995	8,469	2,490	11,954
Rojet e Objekteve	-	-	30,567	30,567
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	7,862	-	15,041	22,903
Reklamë e Publicitet	-	317,404	-	317,404
Marredhenie me publikun	-	11,573	-	11,573
Udhëtime e Dieta	-	-	26,959	26,959
Ujë dhe Energji elektrike	247,520	-	39,192	286,712
Komisionet Bankare	-	-	5,094	5,094
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	503,072	204,948	184,617	892,636
Shpenzime për Materiale	51,101	6,133	42,607	99,841
Shpenzime për Malira	37,848	1,522	22	39,392
Tatime e taksa	-	-	40,257	40,257
Pagat	148,642	348,628	366,722	863,992
Trajtime dhe shpërblime të tjera	171,223	28,885	41,374	241,482
Sigurime shoqërore	43,686	50,407	32,586	126,679
Amortizimi	1,526,110	205,406	175,780	1,907,296
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	-	-	86,366	86,366
Zhvleresim I inventarit	-	-	69,662	69,662
Shpenzime borxh i keq	-	-	10,145	10,145
Zhvleresim i llogarive te arketueshme te tjera	45	215	105,776	106,036
Totali	4,921,032	1,202,185	1,358,649	7,481,866

Sherbimet e marra nga auditues ligjor gjate vitit 2019 detajohen si me poshte:

		31 dhjetor 2019
Mazars shpk	Sherbime dhenie sigurie	3,727
Price Waterhouse Cooper	Sherbime konsulence	508

22. SHPENZIMET (VAZHDIM)

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018			
	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile Telekom Albania	366,775	-	-	366,775
Operatorët Mobile Vodafon	599,831	-	-	599,831
Operatorët Rurale/alternativë	36,946	-	-	36,946
Operatorë të tjerë (vas)	1,351	-	-	1,351
Operatorët Ndërkombëtarë	451,541	-	-	451,541
Shpenzime Interneti	206,798	-	-	206,798
Licensa	190,900	-	-	190,900
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	20,397	18,792	39,189
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	506,214	937	94,478	601,629
Shpenzime Qeraje	212,992	54,452	43,141	310,585
Rojet e Objekteve	-	-	35,411	35,411
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	8,219	-	15,177	23,396
Reklamë e Publicitet	-	472,976	-	472,976
Marredhenie me publikun	-	12,057	-	12,057
Udhëtime e Dieta	-	-	25,708	25,708
Ujë dhe Energji elektrike	254,567	-	42,618	297,185
Komisionet Bankare	-	-	7,160	7,160
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	503,790	330,627	177,569	1,011,986
Shpenzime për Materiale	56,834	11,949	44,068	112,851
Shpenzime për Mallra	55,904	4,116	10	60,030
Tatime e taksa	-	-	30,728	30,728
Pagat	275,677	281,109	307,123	863,909
Trajtime dhe shpërblime të tjera	79,228	-	82,643	161,871
Sigurime shoqërore	39,701	40,483	44,229	124,413
Amortizimi	1,559,685	77,669	194,874	1,832,228
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	-	-	251,094	251,094
Zhvleresim i Inventarit	-	-	14,634	14,634
Shpenzime borxh i keq	-	-	41,613	41,613
Zhvleresim i llogarive te arketueshme te tjera	-	-	10,000	10,000
Shpenzime të tjera rrjedhëse	-	2,087	90,344	92,431
Totali	5,406,953	1,308,859	1,571,414	8,287,226

23. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT

Rezultati nga dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Rezultati nga dalja jashtë përdorimit dhe shitja e AAM-ve	(29,480)	(200,409)
Dalja jashte perdorimi e aktiveve	(19)	(19,906)
Të ardhura të tjera	24,923	14,537
Totali	(4,576)	(205,778)

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	214,379	1,071,486
Shpenzime nga shitja e AAM-ve	(243,859)	(1,271,895)
Rezultati Neto nga shitja e AAM-ve	(29,480)	(200,409)

24. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	89	69
Të ardhura nga këmbimet valutore	2,862,981	6,819,970
Të ardhurat financiare	2,863,070	6,820,039
Shpenzime për interesa	(1,128,069)	(1,045,924)
Humbje nga këmbimet valutore	(2,652,952)	(5,729,534)
Shpenzime te tjera fiananciare	(8,501)	(15,655)
Shpenzimet Financiare	(3,789,522)	(6,791,113)
Rezultati Financiar	(926,452)	28,926

25. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin është përllogaritur si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(550,301)	(329,742)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	1,225,221	1,874,557
Shpenzime borxh i keq	10,145	41,613
Shpenzime për zhvlerësime te drejtash	86,366	251,094
shpenzime per zhvleresime inventari	69,662	14,634
Provizione	-	10,000
Shpenzime per interesa	360,751	403,848
Amortizimi tej normave të lejuara me ligj	2,026	27,568
humbje nga shitja e aseteve	481,440	1,013,793
Amortizimi fiskal	(57,596)	(103,905)
Te ardhura te patatueshme (shitja e borxhit)	(3,947)	(2,162)
Te ardhura te periudhave te meparshme nga IFRS 15	10,940	34,304
Shpenzime amortizimi dhe qiraje nga IFRS 16	53,626	
Shpenzime të tjera	211,808	183,770
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	674,920	1,544,815
Humbje e mbartur	(43,140)	(1,544,815)
Tatim fitimi @15%	(94,767)	-
Fitimi /(Humbja) e vitit	(645,068)	(329,742)

Lëvizjet e tatimi fitmit për vitin 2019 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja më 1 janar	39,714	-
Tatim fitimi i parapaguar	-	39,714
Shpenzimi i periudhës	(94,767)	-
Tatim fitimi I arkëtueshëm (detyrimi)	(55,053)	39,714

Tatimi e shtyrë e llogaritur për vitin 2019 ka të bëjë me sa vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pasive tatimore të shtyra		
Gjendje në fillim të vitit	1,048,868	1,175,429
Efekti në pasqyrën e fitmit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëperfshirëse me normën e tatimit fitimit të vitit aktual	(14,463)	(126,561)
Gjendja në 31 dhjetor	1,034,405	1,048,868

26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqëritë nën të njëjtin kontroll, me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.
Vlerat e paraqitura në seksionin a aktiveve me palët e lidhura me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	16,320	3,901
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	8,590	8,778
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	4	4
Punonjësit e Albtelecom	1,575	1,725
Posta Shqiptare	55,837	109,916
Total llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	82,326	124,324

Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	225	105
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	49,276	82,623
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	12	-
Total mjete monetare pranë palëve te lidhura	49,513	82,728

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Çalık Holding A.Ş.	92,562	223,652
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	1,865	11,107
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	48	1,105
Posta Shqiptare	87,358	130,651
Total llogari të pagueshme me palë të lidhura	181,833	366,515

Huatë me palët e lidhura detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	6,480,613	3,468,102
Çalık Holding A.Ş.	1,800,081	5,705,802
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	3,754,451	1,012,985
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	304,630	-
Total huash me palët e lidhura	12,339,775	10,186,889

26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Shitjet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	120,853	115,606
Posta Shqiptare	24,049	22,423
	144,902	138,029

Blerjet gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	Kosto financiare	668,785	281,998
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	Kosto financiare	86,718	61,861
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	Kosto të tjera	11,885	14,524
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	Kosto financiare	3,332	-
Çalık Holding AŞ	Kosto financiare	101,135	355,814
Çalık Holding AŞ	Shpenzime administative	106,177	105,925
Posta Shqiptare	Shpenzime administative	22,280	5
Total		1,000,312	820,127

Shpërblimet e drejtorëve të përfshira në shpenzimet e Shoqërisë për vitin janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga, shpërblime të organeve drejtuese	142,111	139,597
Paga, shpërblime të anetareve te bordit mbikqyres	41,374	32,336
Total	183,485	171,933

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.
Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërisë fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.1. Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndërtuar bazuar në maturitete kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

	31 dhjetor 2019			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,021,857			1,021,857
Mjete monetare në arkë dhe bankë	95,662			95,662
Totali	1,117,519	-	-	1,117,519
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(3,106,523)	(194,093)	(315,175)	(3,615,791)
Hua	(1,011,374)	(654,995)	(14,322,007)	(15,988,376)
Totali	(4,117,897)	(849,088)	(14,637,182)	(19,604,167)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(3,000,378)	(849,088)	(14,637,182)	(18,486,648)

	31 dhjetor 2018			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	1,047,887			1,047,887
Mjete monetare në arkë dhe bankë	163,847			163,847
Totali	1,211,734	-	-	1,211,734
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,728679)	(156,969)	(581,117)	(3,466,765)
Hua	(2,020,016)	(1,296,657)	(9,468,283)	(12,784,956)
Totali	(4,748,695)	(1,453,626)	(10,049,400)	(16,251,721)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	(3,536,961)	(1,453,626)	(10,049,400)	(15,039,987)

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.2. Risku i normave të interesit

Të ardhurat si dhe rrjedhja e parave nga aktiviteti i shfrytëzimit i shoqërisë ndikohen nga përqindjet e interesit. Shoqëria ka marrë hua afatgjatë me interes të ndryshueshëm dhe me interes fiks. Shoqëria përballet me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me riskun e normave të interesit të çdo depozite afatshkurtër.

Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.
Detajimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	31dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Instrumenta me interest fiks		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	14,218,001	3,747,721
	14,218,001	3,747,721
Instrumenta me interest variable		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	5,294,210	12,504,020
	5,294,210	12,504,020

27.3. Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

Më 31 dhjetor 2019 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	369,422	483,821	(156,042)	170,242	867,443
Mjete monetare në arkë dhe bankë	20,111	2,106	197,755	24	219,996
Totali	389,533	485,927	41,713	170,266	1,087,439
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(4,279,246)	(38,913)	(852,852)	(39,368)	(5,210,379)
Hua	(10,010,057)	-	(4,177,968)		(14,188,025)
Totali	(14,289,303)	(38,913)	(5,030,820)	(39,368)	(19,398,404)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	(13,899,770)	447,014	(4,989,107)	130,898	(18,310,965)

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3. Risku nga monedhat e huaja (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2018 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	220,850	6,880	820,157	-	1,047,887
Mjete monetare në arkë dhe bankë	52,241	726	110,825	55	163,847
Totali	273,091	7,606	930,982	55	1,211,734
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,173,266)	(116,037)	(1,137,089)	(40,374)	(3,466,766)
Hua	(12,194,712)	(320,603)	(269,640)	-	(12,784,955)
Totali	(14,367,978)	(436,640)	(1,406,729)	(40,374)	(16,251,721)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	(14,094,887)	(429,034)	(475,747)	(40,319)	(15,039,987)

27.4. Risku i kreditit

Politika e shoqërisë stimulon klientët të konsumojnë shërbimin në avancë kundrejt pagesës së mëvonshme. Ndërkohë balanca e llogarive të arkëtueshme monitorohet në vazhdimësi në mënyrë që rezultati i ekspozimit të shoqërisë ndaj borxheve të këqija të mos jetë i konsiderueshëm.
Testi i vlerës së llogarive të arkëtueshme kryhet në çdo datë raportimi në baza individuale për klientët e mëdhenj. Klientët e vegjël grupohen në grupe homogjene dhe testohen në mënyrë kolektive.
Tabela më poshte paraqet aktivet financiare për vitin mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme tregtare	860,302	890,121
Llogari të arkëtueshme të tjera	161,555	157,766
Mjete monetare	95,662	163,847
	1,117,519	1,211,734

Detaje mbi moshën e të arkëtueshmeve dhe zhvlerësimin e tyre paraqiten në shënimin 9 të pasqyrave financiare.

28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Angazhimet vjetore për qira operative janë si më poshtë:

	31dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Brenda një viti	5,711	233,228
Më shumë se një vit, më pak se pesë vjet	7,695	449,692
Me shume se 5 vjet	-	59,547
	13,406	742,467

Shoqëria është e përfshirë në çështje gjyqësore të ndryshme gjatë rrjedhës normale të biznesit. Në gjykimin e manaxhimit rezultati final i këtyre çështjeve nuk do të ketë një impakt material në rezultatin aktual të shoqërisë.

29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 31 dhjetor 2019 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

ALBtelecom sh.a.
NR. 1838 PROT.
DATË 22.3.2021

Albtelecom sh.a

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR 1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES 5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE 6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE 7
PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA 8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE 9
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM 9
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE 9
3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR 12
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL 13
5. GJYKIME MBI EFEKTET E PANDEMISE NE PARIMIN E VIJIMESISE 25
6. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE 26
7. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE 27
8. AKTIVET NË PËRDORIM 28
9. AKTIVET INVESTUESE 28
10. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA 28
11. INVENTARI 29
12. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA 29
13. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA 31
14. MJETET MONETARE 31
15. KAPITALI AKSIONAR 32
16. HUATË 33
17. Qiraja financiare 35
18. PROVIZIONET 35
19. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE 36
20. GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA 36
21. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME 37
22. SHITJET NETO 38
23. SHPENZIMET 39
24. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT 41
25. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE 41
26. TATIMI MBI FITIMIN 42
27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA 43
28. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR 44
29 ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA 48
30 NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT 48

mazars

Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

1838
23.3.2021

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Albtelecom sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albtelecom sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars

Informacione te tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera janë të gjitha informacionet e dhëna në raportin vjetor, përveç pasqyrave financiare, raportit të drejtimit dhe raportit të auditimit.

Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione te tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

23 mars 2021

Teit Gjini
Auditues Ligjor

ALBTELECOM SH.A

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2020 (000/Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	21,309,810	21,984,055
Aktivet afatgjata jomateriale	7	2,188,670	2,393,750
Asete ne perdorim	8	2,383,635	2,600,561
Aktive investuese	9	135,029	193,962
Të tjera llogari të arkëtueshme	10	22,360	24,696
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13	15,455	18,180
Totali i aktiveve afatgjata		26,054,959	27,215,204
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	11	546,129	322,854
Llogari të arkëtueshme tregtare	12	762,614	860,302
Tatim fitimi i parapaguar	26	57,130	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	80,493	136,859
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13	162,079	108,973
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	71,040	95,662
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,679,485	1,524,650
Totali i aktiveve		27,734,444	28,739,854
KAPITALI			
Kapitali themeltar		18,250,000	18,250,000
Rezerva rivlerësimi dhe të tjera		2,709,659	2,776,815
Rezerva ligjore		232,302	232,302
Fitime të mbartura		(14,823,675)	(13,672,532)
Totali i kapitalit	15	6,368,286	7,586,585
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	13,116,017	11,838,609
Pjesa afatgjatë e qirasë financiare	17	2,234,999	2,483,398
Provizione	18	98,200	55,263
Llogari të pagueshme afatgjata	19	160,085	315,175
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	20	317,160	293,205
Tatim i shtyrë mbi fitimin	26	990,958	1,034,405
Totali i detyrimeve afatgjata		16,917,419	16,020,055
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	16	1,111,419	1,298,536
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	17	356,690	367,833
Llogari të pagueshme tregtare	19	2,749,945	3,146,890
Tatim Fitimi	26	-	55,053
Provizione	18	49,383	49,383
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	20	69,797	61,793
Llogari të pagueshme të tjera	21	111,505	153,726
Totali i detyrimeve afatshkurtra		4,448,739	5,133,214
Totali i detyrimeve		21,366,158	21,153,269
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		27,734,444	28,739,854

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	7,189,385	7,862,593
Kosto e shërbimeve të shitura	23	(4,676,461)	(4,921,032)
Total të ardhura		**2,512,924**	**2,941,561**
Shpenzimet e shitjes dhe të shpërndarjes	23	(1,176,271)	(1,202,185)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	23	(1,222,633)	(1,358,649)
Të ardhura/shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	24	(67,131)	(4,576)
Fitimi operativ		**46,889**	**376,151**
Shpenzime/ te ardhura per interesa	25	(955,759)	(1,127,980)
Të ardhura/shpenzime financiare neto	25	(266,375)	201,528
Fitimi/humbja para tatimit		**(1,175,245)**	**(550,301)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	**(94,767)**
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(94,767)
Fitimi/humbja e vitit		**(1,175,245)**	**(645,068)**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(000/Lekë)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimi/humbja e vitit	(1,175,245)	(645,068)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
Zëra që nuk do të riklasifikohen më vonë ne fitim/humbje:		
Tatimi fitimi i shtyrë që regjistrohetdirekt ne te ardhura te tjera gjitheperfshirese	43,446	14,463
Rivlerësimi makineri e pajisjeve	(67,156)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	(23,710)	14,463
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	(1,198,955)	(630,605)

Shënimet shpjeguese nga faqja 8-46 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		(1,175,245)	(550,301)
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Amortizimi		1,906,040	1,931,064
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi capital		201,803	29,499
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme		-	96,511
Zhvlerësimi i inventarit		49,027	69,662
Provizione		42,937	-
Shpenzime për interesa		821,494	1,012,105
Ndryshimi në kapitalin qarkullues:			
Rënie/(rritje) në inventor		(272,302)	(40,438)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		48,879	32,800
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		(617,350)	102,167
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		1,005,284	2,683,069
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(1,228,109)	(2,070,837)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		188,949	227,874
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		(1,039,160)	(1,842,963)
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		1,277,408	2,370,328
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		(1,008,611)	(3,030,244)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		(259,542)	(248,375)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		9,255	(908,291)
Ndryshimi neto I mjeteve monetare		(24,622)	(68,185)
Mjetet monetare në fillim të periudhës		95,662	163,847
Mjetet monetare në fund të periudhës	14	71,040	95,662

Shënimet shpjeguese nga faqja 8-46 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (000/Lekë)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva rivlerësimi	Rezerva ligjore	Fitim/humbje të akumuluara	Totali
01 janar 2019	18,250,000	23,153	2,753,662	232,302	(13,041,927)	8,217,190
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(645,068)	(645,068)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	14,463	14,463
31 dhjetor 2019	18,250,000	23,153	2,753,662	232,302	(13,672,532)	7,586,585
Efekti i ndryshimeve te politikave kontabel dhe sistemime te periudhave te meparshme	-	-	-	-	(19,344)	(19,344)
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(1,175,245)	(1,175,245)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(67,156)	-	-	(67,156)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse nga tatimi i shtyre	-	-	-	-	43,446	43,446
31 dhjetor 2020	18,250,000	23,153	2,686,506	232,302	(14,823,675)	6,368,286

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të vitit 2020, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë 23/06/2021 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Burak Yurtsever

Zv/Drejtor i Përgjithshëm

Myrvete FERHATI

Dr/ Drejtorisë Kontabilitetit dhe Taksave

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

"ALBTELECOM" SH.A. është regjistruar si shoqëri aksionere me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, numër 20820 datë 18.02.1999, të Regjistrit Tregtar, në përputhje me ligjin Nr 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Kapitali i shoqërisë është 18,250,000 mijë lekë.

Shoqëria ofron një gamë të gjerë shërbimesh të tilla si: shërbimi i telefonisë fikse, interkonjeksionit për operatorë të tjerë, internetit, shërbimit ADSL, ISDN, linjave me qira, kartave të parapaguara dhe shërbimeve të tjera të telekomunikacionit.

Organi drejtues i Shoqërisë është këshilli administrativ.

Organi drejtues:

Emri	Funksioni	Vendodhja
Hydajet Kopani	Kryetar	Tiranë
Ahmet Galip Tozge	Anëtar	Turqi
Umut Onal	Anëtar	Turqi
Ali Ihsan Kuralkan	Anëtar	Turqi
Bilgen Aldan	Administratori/Anëtar	Turqi
Serdar Sumer	Anëtar	Turqi
Rudolf Papa	Anëtar	Tiranë
Mahmut Can Calik	Anëtar	Turqi
Tahsin Yilmaz	Anëtar	Turqi

Selia e shoqërisë është Autostrada Tiranë – Durrës, Km 7, Kashar, Tiranë.
Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me Licensë Nr. 3898113 dhe NIPT J61824053N.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2019 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

2.2 Baza e matjeve

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.4. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më te afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore.

Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

2.5.2. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.
Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.4. Provizione

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund te mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përkufizimi i një biznesi (Amendime në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Amendime në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)
- Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.
Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim I SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

4.1. Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqiperisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në Lek):

Monedha	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
1 EUR	123.7	121.77
1 USD	100.84	108.64
1 GBP	137.93	143
1 SDR	145.24	150.23

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.4 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4.2. Instrumentat Financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Licensa	190,779	-	-	190,779
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	17,388	18,171	35,559
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	526,361	1,207	65,221	592,789
Shpenzime Qiraje	995	8,469	2,490	11,954
Rojet e Objekteve	-	-	30,567	30,567
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	7,862		15,041	22,903
Reklamë e Publicitet	-	317,404	-	317,404
Marredhenie me Publikun	-	11,573	-	11,573
Udhëtime e Dieta	-	-	26,959	26,959
Ujë dhe Energji elektrike	247,520	-	39,192	286,712
Komisionet Bankare	-	-	5,094	5,094
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	503,071	233,833	184,617	921,521
Shpenzime për Materiale	51,101	6,133	42,607	99,841
Shpenzime për Mallra	37,848	1,522	22	39,392
Tatime e taksa			40,257	40,257
Pagat	132,193	348,628	366,722	847,543
Trajtime dhe shpërblime të tjera	171,223	-	41,374	212,597
Sigurime shoqërore	60,135	50,407	32,586	143,128
Amortizimi	1,526,110	205,406	175,780	1,907,296
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-	-	86,366	86,366
Zhvlerësim i inventarit	-	-	69,662	69,662
Shpenzime borxh i keq	-	-	10,145	10,145
Shpenzime të tjera rrjedhëse	45	215	105,776	106,036
Totali per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	**4,921,032**	**1,202,185**	**1,358,649**	**7,481,866**

24. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Rezultati nga dalja jashtë përdorimit dhe shitja e AAM-ve	(158,577)	(29,499)
Të ardhura të tjera	91,446	24,923
	(67,131)	(4,576)

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	188,949	214,379
Shpenzime nga shitja e AAM-ve	(347,526)	(243,878)
Rezultati Neto nga shitja e AAM-ve	**(158,577)**	**(29,499)**

25. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga interesat	27	89
Të ardhura nga këmbimet valutore	(4,013,810)	2,862,981
Të ardhurat financiare	**(4,013,783)**	**2,863,070**
Shpenzime për interesa	(955,786)	(1,128,069)
Humbje nga këmbimet valutore	3,748,565	(2,652,952)
Shpenzime te tjera fiananciare	(1,130)	(8,501)
Shpenzimet Financiare	**2,791,649**	**(3,789,522)**
Rezultati Financiar	**(1,222,134)**	**(926,452)**

26. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin është përllogaritur si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	(1,175,245)	(550,301)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	534,608	1,225,221
Shpenzime borxh i keq	3,893	10,145
Shpenzime për zhvlerësime te drejtash	-	86,366
shpenzime për zhvleresime inventari	-	69,662
Provizione	91,964	-
Shpenzime për interesa	256,585	360,751
Amortizimi tej normave të lejuara me ligj	2,349	2,026
Humbje nga shitja e aseteve	19,819	481,440
Amortizimi fiskal	(34,586)	(57,596)
Të ardhura të patatueshme (shitja e borxhit)	-	(3,947)
Të ardhura të periudhave të mëparshme nga SNRF 15	8,629	10,940
Shpenzime amortizimi dhe qiraje nga SNRF 16	59,029	53,626
Shpenzime të tjera	126,926	211,808
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(640,637)	674,920
Humbje e mbartur	-	(43,140)
Tatim fitimi @15%	-	(94,767)
Fitimi /(Humbja) e vitit	(1,175,245)	(645,068)

Lëvizjet e tatimi fitmit për vitin 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar	(55,053)	39,714
Tatim fitimi i parapaguar	112,183	-
Shpenzimi i periudhës	-	(94,767)
Tatim fitimi i arkëtueshëm (detyrimi)	57,130	(55,053)

Tatimi i shtyrë e llogaritur për vitin 2020 ka të bëjë me sa vijon:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasive tatimore të shtyra		
Gjendje në fillim të vitit	1,034,405	1,048,868
Efekti në pasqyrën e fitmit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëperfshirëse me normën e tatimit fitimit të vitit aktual	(43,447)	(14,463)
Tatimi i shtyrë më 31 dhjetor	990,958	1,034,405

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqëritë nën të njëjtin kontroll, me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.
Vlerat e paraqitura në seksionin a aktiveve me palët e lidhura me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	4,123	16,320
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	3,275	8,590
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	4	4
Punonjësit e Albtelecom	1,425	1,575
Posta Shqiptare	57,615	55,837
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	2,146	-
Total llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	**68,588**	**82,326**
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	13	225
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	37,382	49,276
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	67	12
Total mjete monetare pranë palëve të lidhura	**37,462**	**49,513**

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Çalık Holding A.Ş.	186,911	92,562
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	-	1,865
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	576	48
Posta Shqiptare	44,101	87,358
Total llogari të pagueshme me palë të lidhura	**231,588**	**181,833**

Huatë me palët e lidhura detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	5,344,625	6,480,613
Çalık Holding A.Ş.	3,880,771	1,800,081
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	3,797,402	3,754,451
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	291,833	304,630
Total hua me palët e lidhura	**13,314,631**	**12,339,775**

27. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Shitjet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si mëposhtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	125,027	120,853
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	1,082	-
Posta Shqiptare	14,189	24,049
	140,298	144,902

Blerjet gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	398,058	668,785
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	189,514	86,718
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	22,470	11,885
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	19,403	3,332
Çalık Holding AŞ	162,350	101,135
Çalık Holding AŞ	86,246	106,177
Posta Shqiptare	3,189	22,280
	881,230	1,000,312

Shpërblimet e drejtorëve të përfshira në shpenzimet e Shoqërisë për vitin janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga, shpërblime të organeve drejtuese	157,711	142,111
Paga, shpërblime të anetareve te bordit mbikqyres	37,020	41,374
	194,731	183,485

28. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.
Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërisë fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

28. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

28.1 Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndërtuar bazuar në maturitete kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

	31 dhjetor 2020			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	909,460	78,254	2,337,648	3,325,362
Mjete monetare në arkë dhe bankë	71,040			71,040
Totali	**980,500**	**78,254**	**2,337,648**	**3,396,402**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,781,407)	(80,043)	(160,085)	(3,021,535)
Hua	(377,395)	(734,024)	(13,116,017)	(14,227,436)
Totali	**(3,158,802)**	**(814,067)**	**(13,276,102)**	**(17,248,971)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	**(2,178,302)**	**(735,813)**	**(10,938,454)**	**(13,852,569)**

	31 dhjetor 2019			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	847,299	91,727	2,806,720	3,745,746
Mjete monetare në arkë dhe bankë	95,662			95,662
Totali	**942,961**	**91,727**	**2,806,720**	**3,841,408**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(3,106,523)	(194,093)	(315,175)	(3,615,791)
Hua	(1,011,374)	(654,995)	(14,322,007)	(15,988,376)
Totali	**(4,117,897)**	**(849,088)**	**(14,637,182)**	**(19,604,167)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	**(3,174,936)**	**(757,361)**	**(11,830,462)**	**(15,762,759)**

28. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

28.2 Risku i normave të interesit

Të ardhurat si dhe rrjedhja e parave nga aktiviteti i shfrytëzimit i shoqërisë ndikohen nga përqindjet e interesit. Shoqëria ka marrë hua afatgjatë me interes të ndryshueshëm dhe me interes fiks. Shoqëria përballet me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me riskun e normave të interesit të çdo depozite afatshkurtër.

Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.
Detajimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Instrumenta me interes fiks		
Detyrime Financiare	5,555,928	6,735,874
Risku i interesit	**5,555,928**	**6,735,874**
Instrumenta me interes variabel		
Detyrime Financiare	8,671,508	6,401,271
Risku i interesit	**8,671,508**	**6,401,271**

28.3 Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

Më 31 dhjetor 2020 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	227,985	352,951	2,579,905	164,521	3,325,362
Mjete monetare në arkë dhe bankë	59	1,083	69,821	77	71,040
Totali	**228,044**	**354,034**	**2,649,726**	**164,598**	**3,396,402**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,872,495)	(59,066)	(1,079,046)	(10,928)	(3,021,535)
Hua	(10,027,384)		(4,200,052)	-	(14,227,436)
Totali	**(11,899,879)**	**(59,066)**	**(5,279,098)**	**(10,928)**	**(17,248,971)**
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2020	(11,671,834)	294,968	(2,629,372)	153,670	(13,852,569)

28 INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

28.3 Risku nga monedhat e huaja (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2019 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	369,422	483,821	2,722,261	170,242	3,745,746
Mjete monetare në arkë dhe bankë	20,111	2,106	73,421	24	95,662
Totali	389,533	485,927	2,795,682	170,266	3,841,408
Llogari` tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,684,658)	(38,913)	(852,852)	(39,368)	(3,615,791)
Hua	(9,772,829)	-	(3,364,316)	-	(13,137,145)
Totali	(12,457,487)	(38,913)	(4,217,168)	(39,368)	(16,752,936)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	(12,067,954)	447,014	(1,421,486)	130,898	(12,911,528)

28.4 Risku i kreditit

Politika e shoqërisë stimulon klientët të konsumojnë shërbimin në avancë kundrejt pagesës së mëvonshme. Ndërkohë balanca e llogarive të arkëtueshme monitorohet në vazhdimësi në mënyrë që rezultati i ekspozimit të shoqërisë ndaj borxheve të këqija të mos jetë i konsiderueshëm.
Testi i vlerës së llogarive të arkëtueshme kryhet në çdo datë raportimi në baza individuale për klientët e mëdhenj. Klientët e vegjël grupohen në grupe homogjene dhe testohen në mënyrë kolektive.
Tabela më poshte paraqet aktivet financiare për vitin mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme tregtare	762,614	860,302
Llogari të arkëtueshme të tjera	80,493	161,555
Mjete monetare	71,040	95,662
	914,147	1,117,519

Detaje mbi moshën e të arkëtueshmeve dhe zhvlerësimin e tyre paraqiten në shënimin 12 të pasqyrave financiare.

29 ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Angazhimet vjetore për qira operative janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Brenda një viti	3,734	5,711
Më shumë se një vit, më pak se pesë vjet	3,946	7,695
Më shumë se 5 vjet	-	-
	7,680	13,406

Shoqëria është e përfshirë në çështje gjyqësore të ndryshme gjatë rrjedhës normale të biznesit. Në gjykimin e manaxhimit rezultati final i këtyre çështjeve nuk do të ketë një impakt material në rezultatin aktual të shoqërisë.

30 NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 15 shkurt 2021 bordi drejtues emëron znj. Bilgen Aldan në postin e Drejtores së Përgjithshme të kompanisë.

Më 31 dhjetor 2020 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al

Albtelecom sh.a

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

PËRMBAJTJA

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR 1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES 5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE 6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE 7
PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA 8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE 9
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM 9
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE 9
3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR 12
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL 13
5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE 25
6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE 26
7. AKTIVET NË PËRDORIM 27
8. AKTIVET INVESTUESE 28
9. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA 28
10. INVENTARI 28
11. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATSHKURTRA 29
12. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA 30
13. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË 30
14. KAPITALI AKSIONAR 31
15. HUATË 32
16. QIRAJA FINANCIARE 34
17. PROVIZIONET 34
18. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE 35
19. GRANTET, TË ARDHURAT E SHTYRA DHE DETYRIME TË TJERA 35
20. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA 36
21. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT 37
22. SHPENZIMET 38
23. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT 40
24. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE 40
25. TATIMI MBI FITIMIN 41
26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA 42
27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR 44
28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA 47
29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT 47

mazars

Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Albtelecom sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albtelecom sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera janë të gjitha informacionet e dhëna në raportin vjetor ne perputhje me nenet 17, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare, dhe raportin e auditimit mbi keto pasqyra.

Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

mazars

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

28 mars 2022

mazars
Emin Duraku Str., Binjaku Buld.,
No.8, 1013, Tirana, Albania
NUIS K32123006W

Teit Gjini
Auditues Ligjor

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2021 (000/Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	20,525,751	21,309,810
Aktivet afatgjata jomateriale	6	1,976,659	2,188,670
Aktivet në përdorim	7	2,616,940	2,383,635
Aktive investuese	8	-	135,029
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	19,467	22,360
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	19,335	15,455
Totali i aktiveve afatgjata		**25,158,152**	**26,054,959**
Aktivet afatshkurtra			
Inventari	10	313,891	546,129
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	842,020	762,614
Tatim fitimi i parapaguar	25	80,821	57,130
Llogari të arkëtueshme të tjera	11	73,910	80,493
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	91,962	162,079
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	152,232	71,040
Totali i aktiveve afatshkurtra		**1,554,836**	**1,679,485**
Totali i aktiveve		**26,712,988**	**27,734,444**
KAPITALI			
Kapitali themeltar		18,250,000	18,250,000
Rezerva rivlerësimi		2,574,133	2,709,659
Rezerva ligjore		232,302	232,302
Fitime/humbje të mbartura		(15,347,004)	(14,823,675)
Totali i kapitalit	14	**5,709,431**	**6,368,286**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	12,634,342	13,116,017
Qira financiare	16	2,467,007	2,234,999
Provizione	17	98,200	98,200
Llogari të pagueshme tregtare	18	-	160,085
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	19	296,756	317,160
Tatim fitimi i shtyrë mbi fitimin	25	974,408	990,958
Totali i detyrimeve afatgjata		**16,470,713**	**16,917,419**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	15	1,635,235	1,111,419
Qira financiare	16	471,344	356,690
Llogari të pagueshme tregtare	18	2,190,359	2,749,945
Provizione	17	49,383	49,383
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	19	69,874	69,797
Llogari të pagueshme të tjera	20	116,649	111,505
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**4,532,844**	**4,448,739**
Totali i detyrimeve		**21,003,557**	**21,366,158**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**26,712,988**	**27,734,444**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	6,923,393	7,189,385
Kosto e shërbimeve te shitura	22	(4,591,981)	(4,676,461)
Total të ardhura		**2,331,412**	**2,512,924**
Shpenzimet e shitjes dhe të shpërndarjes	22	(1,056,424)	(1,176,271)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	22	(1,286,593)	(1,222,633)
Të ardhura/shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	23	19,224	(67,131)
Fitimi operativ		**7,619**	**46,889**
Interesa/ (shpenzime) për interesa	24	(872,517)	(955,759)
Të ardhura/shpenzime financiare neto	24	325,019	(266,375)
Fitimi/humbja para tatimit		**(539,879)**	**(1,175,245)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit		**(539,879)**	**(1,175,245)**

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(000/Lekë)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi/humbja e vitit	(539,879)	(1,175,245)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		
Zëra që nuk do të riklasifikohen më vonë në fitim/humbje:		
Tatimi fitimi i shtyrë që regjistrohet direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	16,550	43,446
Rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	(135,526)	(67,156)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	(118,976)	(23,710)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	(658,855)	(1,198,955)

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 (000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		(539,879)	(1,175,245)
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Amortizimi		1,876,813	1,906,040
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital		15,137	201,803
Zhvlerësimi i llogarive te arkëtueshme		(10,057)	-
Zhvlerësimi i inventarit		80,833	49,027
Provizione		-	42,937
Shpenzime për interesa		728,766	821,494
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Rënie/(rritje) në inventar		151,405	(272,302)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		6,364	48,879
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		(734,854)	(617,350)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		1,574,548	1,005,283
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(23,691)	-
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative		1,550,857	1,005,283
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(692,628)	(1,228,109)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		637	188,949
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		(691,991)	(1,039,160)
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		(481,675)	1,277,408
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		(204,970)	(1,008,611)
(Ripagim)/ të hyra nga qerate financiare		(91,029)	(259,542)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		(777,674)	9,255
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		81,192	(24,622)
Mjetet monetare në fillim të periudhës		71,040	95,662
Mjetet monetare në fund të periudhës	13	152,232	71,040

Shëniimet shpjeguese nga janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(000/Lekë)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva rivlerësimi	Rezerva ligjore	Fitim /humbje të akumuluara	Totali
1 janar 2020	18,250,000	23,153	2,753,662	232,302	(13,672,532)	7,586,585
Efekti i ndryshimeve të politikave kontabël dhe sistemime të periudhave të mëparshme	-	-	-	-	(19,344)	(19,344)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	(67,156)	-	-	(67,156)
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(1,175,245)	(1,175,245)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse nga tatimi i shtyre	-	-	-	-	43,446	43,446
31 dhjetor 2020	18,250,000	23,153	2,686,506	232,302	(14,823,675)	6,368,286
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(539,879)	(539,879)
Shtim i rezervës së rivlerësimit	-	-	(135,526)	-	-	(135,526)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse tatim i shtyrë	-	-	-	-	16,550	16,550
31 dhjetor 2021	18,250,000	23,153	2,550,980	232,302	(15,347,004)	5,709,431

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të vitit 2021, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë 26 / 05 /2022 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Burak Yurtsever

Zv/Drejtor i Përgjithshëm

Myrvete FERHATI

Dr/ Drejtorisë Kontabilitetit dhe Taksave

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

"ALBTELECOM" SH.A. është regjistruar si shoqëri aksionere me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, numër 20820 datë 18.02.1999, të Regjistrit Tregtar, në përputhje me ligjin Nr 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Kapitali i shoqërisë është 18,250,000 mijë lekë.

Shoqëria ofron një gamë të gjerë shërbimesh të telefonisë fikse (1Play, 2Play, 3Play, 4Play), shërbimet e telefonisë mobile (prepaid dhe postpaid, internet, data), shërbimet e shitjes me shumicë si: interkoneksionit kombëtar dhe ndërkombëtar, tranzitimit, shërbimet e roaming, data lease line, shërbim interneti, dhënia me qira e objekteve etj.

Organi drejtues i Shoqërisë është këshilli administrativ.

Anëtarët e Bordit deri më 03.03.2022:

Emri	Funksioni	Vendodhja
Ahmet Galip Tozge	Anëtar	Turqi
Umut Onal	Anëtar	Turqi
Ali Ihsan Kuralkan	Anëtar	Turqi
Bilgen Aldan	Administratori/Anëtar	Turqi
Serdar Sumer	Anëtar	Turqi
Irida Peci	Anëtar	Shqipëri
Mahmut Can Calik	Anëtar	Turqi

Anëtarët e rinj të Bordit duke filluar nga data 04.03.2022:

Emri	Funksioni	Vendodhja
Péter Krisztián Fekete	Anëtar	Hungari
Aladin Ádám Linczényi	Anëtar	Hungari
Csaba Ferenc Thurzó	Anëtar	Hungari
Laszlo Blenessy	Anëtar	Hungari
Irida Peci	Anëtar	Shqipëri

Selia e shoqërisë është Rruga "Muhedin Llagami", Sheshi 21, Tiranë.
Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me Licensë Nr. 3898113 dhe NIPT J61824053N.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2020 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

2.2 Baza e matjeve

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më te afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore.

Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

2.5.2. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore.

Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.4. Provizione

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund te mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.
Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Kontratat me kushte – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) – Në fuqi nga 1 janari 2022
- Aktive afatgjatë materiale: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3). Në fuqi nga 1 janari 2022
- Dhënia e shënimeve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

4.1. Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqiperisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në Lek):

Monedha	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
1 EUR	120.76	123.7
1 USD	106.54	100.84
1 GBP	143.95	137.93
1 SDR	149.11	145.24

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.4 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4.2. Instrumentat Financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e flukseve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak te maturimit të tyre afatshkurtër.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.4 Inventari

Inventarët që përfshijnë kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesorët përkatës dhe kancelari e paisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Zërat e llogarisë toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje të telekomunikacionit janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kosto historike përfshin çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit, dhe taksa të pakthyeshme në blerje, pasi pakësohet nga zbritjet tregtare, çdo kosto tjetër për të sjellë aktivin në vendodhjen dhe kushtet e nevojshme në mënyrë që të jetë i gatshëm për përdorim në mënyrën e parashikuar nga manaxhimi i shoqërisë, si dhe kostot për çmontimin e asetit në rast se është e nevojshme.

Çdo interes i lidhur me një aktiv afatgjatë material në ndërtim, kapitalizohet në momentin kur fillon ndërtimi i aktivit dhe pushon së kapitalizuari në momentin kur aktivi përfundon së ndërtuari.

Kosto historike e pajisjeve të telekomunikacionit përfshin të gjitha shpenzimet përfshirë dhe shtrirjen e rrjetit në ambjentet e konsumatorëve. Kosto përfshin punën e gjeneruar së brendshmi për një zë specifik të aktiveve afatgjata materiale.

Kostot e mëpasshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të asetit, ose njihen si aset më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin ne fjalë, do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e një pjese që zëvendësohet çrregjistrohet. Të gjitha kostot e mirëmbajteve dhe riparimeve i ngarkohen periudhës financiare në të cilën kane ndodhur.

Ndërtimi në proçes përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjata materiale ende të papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende të papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ ose paraardhëse financiare. Pas përfundimit, këto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proçes, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjata materiale.

Për të përcaktur nëse një aktiv që ka në përbërjen e tij si elemente materialë ashtu dhe jomaterialë, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Amortizimi vjetor paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Normat vjetore të amortizimit aplikohen mbi vlerën e mbetur të aktiveve dhe janë si vijon:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2021	2020
Ndërtesa	3%	3%
Instalime Teknike (Linja)	3%	3%
Makineri e pajisje	15%	15%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje orendi	20%	20%
Pajisje elektronike	25%	25%

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Shoqëria për efekte fiskale operon me normat:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2021	2020
Ndërtesa	5%	5%
Instalime Teknike (Linja)	5%	5%
Makineri e paisje	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje orendi	20%	20%
Pajisje elektronike	25%	25%

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përftuar përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më te hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.7 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe të drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja

Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatesia e parashikuar e aktiveve për periudhat aktuale dhe krahasuese është 7 vjet.

4.8 Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyre të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi anullohet nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe nëse kanë ndryshuar supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar pasi të ishte zbritur zhvlerësimi dhe amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

4.PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.9 Aktive investuese

Aktivi investues është aktiv i mbajtur për t'u dhënë me qira dhe/ose rivlerësim i kapitalit (përfshirë aktivet në ndërtim për qëllime të tilla), fillimisht maten me kosto, përfshirë kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen në Shoqëri pavarësisht nëse titulli është transferuar apo jo. Fillimisht maten me kosto. Pas periudhës së njohjes, aktivet e investimit maten me modelin e kostos. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve të investimit llogaritet bazuar në vlerën e tyre të mbetur. Aktivet e investimeve të mbajtura nga një qiramarrës si një aktiv i përdorimit të drejtë maten fillimisht me koston në përputhje me SNRF 16.

4.10 Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur duke pakësuar shpenzimet e amortizimit të periudhes në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjate jetës së dobishme të aktivit.

4.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë të rëndësishme.

4.12 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fitime te gjeneruara gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqerisë. Te ardhurat njihen per shumen e çmimit te transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.
Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

Të ardhurat nga shërbimet

Shoqeria ofron shërbime me kontrata me çmim fiks dhe me çmime të ndryshueshme. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen. Për kontratat me çmim fiks, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit aktual të ofruar deri në fund të periudhës raportuese si një pjesë e totalit të shërbimeve që duhet të ofrohen, sepse klienti merr dhe përdor përfitimet njëkohësisht.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Kur kontratat përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit.

Matja e të ardhurave, kostove ose fazes së progresit drejt përfundimit rishikohen nëse rrethanat ndryshojnë. Çdo rritje ose zvogëlim i të ardhurave ose shpenzimeve të llogaritura reflektohet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën rrethanat që sjellin rishikimin bëhen të njohura nga drejtimi.
Në rastin e kontratave me çmim fiks, klienti paguan shumën fikse bazuar në një skemë pagesash. Nëse shërbimet e kryera nga Shoqeria e tejkalojnë pagesën, njihet një aktiv i kontratës. Nëse pagesat tejkalojnë shërbimet e kryera, njihet një detyrim kontrate.

Nëse kontrata përfshin shuma te ndryshueshme, të ardhurat njihen vetëm në masën që ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë lidhur me shumën e ndryshueshme nuk do të sjellë anullim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluara të njohura.

Shoqeria nuk pret që të ketë ndonjë kontratë ku periudha ndërmjet transferimit të mallrave ose shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti kalon një vit. Si pasojë, Shoqeria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën kohore të parasë.

Të ardhurat nga shërbimet konsistojnë në:

- tarifat e abonimit,
- tarifat e shërbimit telefonik,
- pajtimi mujor dhe shërbime të tjera,
- tarifat roaming,
- shërbimet e interkonjeksionit.

Të ardhurat nga këto shërbime njihen si më poshtë:

Tarifat e abonimit

Të ardhurat e lidhura me tarifat mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (Vazhdim)

Shërbimi telefonik, pajtimi mujor dhe tarifa të tjera

Shërbimi telefonik bazohet në trafikun e krijuar nga koha e bisedes se kryer nga abonenti, tarifa e aplikuar, destinacioni i thirrjes dhe lloji i shërbimit. Tarifat e shërbimit telefonik varen nga trafiku, koha e bisedës së përdorur apo volumi i të dhënave të transmetuara për shërbimet me vlerë të shtuar, përdorimi i internetit dhe shërbimet e të dhënave. Të ardhurat nga sherbimi telefonik dhe shërbimet me vlerë të shtuar njihen në periudhën kur shërbimet ofrohen. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimit që daton në fund të çdo muaji, përllogariten në bazë të trafikut dhe regjistrohen në fund te muajit.

Kur kontratat përfshijnë dhënien e mallrave falas/me çmim te reduktuar, vouchera, ose shërbime shtese, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit. Te ardhurat nga shërbimi njihen vetëm per pjesën relative te çmimit te transaksionit.

Shitja e Kartave të parapaguara

Të ardhurat nga shitja e kartave rimbushëse me parapagesë dhe kohës së bisedës për shërbimin me parapagesë, neto nga uljet e lejuara, të përfshira në paketat e shërbimit me parapagesë të Shoqërisë, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tarifat Roaming

Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në të njëjtën mënyrë edhe operatorët faturojnë Shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur shërbimet janë ofruar.

Tarifat e Interkonjeksionit

Të gjitha thirrjet që kanë një numër Albtelecom si numër terminimi dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër origjinues, krijojnë një marrëdhënie të ardhurash midis ALBTELECOM-it dhe shoqërisë tjetër. Këto të ardhura njihen si të ardhura interkonjeksioni mes dy shoqërive.
Të ardhurat e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet që terminojne në rrjetin e ALBTELECOM-it nga rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular.

Të gjitha thirrjet që kanë një numër ALBTELECOM si numër origjinues dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër terminues, krijojnë një marrëdhënie kostoje midis shoqërisë tjetër dhe ALBTELECOM-it. Kjo kosto njihet si kosto interkonjeksioni mes dy shoqërive. Kostot e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet e origjinuara në rrjetin e ALBTELECOM-it dhe të terminuara në rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular, duke përdorur rrjetet e shoqerive.

Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën kur thirrja merret/pranohet në rrjetin e Shoqërise (dhe në rrjetin e operatorit tjeter përkatësisht)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (Vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave ose dhenia e tyre falas/me cmim te reduktuar njihen kur kontrolli i mallit është transferuar, pra kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, klienti ka te drejta te plota mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave të klientit. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendodhjen specifike, rreziqet e humbjes janë transferuar tek klienti dhe klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën ose Shoqeria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.
Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, neto nga uljet. Përvoja e akumuluar përdoret për të vlerësuar sigurine mbi zbritjet, duke përdorur metodën e vlerës së pritshme dhe të ardhurat njihen vetëm në masën që është shumë e mundshme që një ndryshim i rëndësishëm nuk do të ndodhë.
Detyrimi i Shoqerise për të riparuar ose zëvendësuar mallrat sipas kushteve standarde të garancisë njihet si një provizion.

Kur kontratat përfshijnë dhënien e mallrave falas/me çmim te reduktuar, vouchera, ose shërbime shtese, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit. Te ardhurat nga mallrat e dhena falas ose me çmim të reduktuar dhe nga voucherat njihen vetëm per pjesën relative te çmimit te transaksionit.

Të ardhurat nga shitja e aksesorëve, neto nga uljet e lejuara, njihen në momentin e dorëzimit të mallrave kur e drejta e pronësisë dhe rreziku i humbjes i kalojnë klientit.

Të ardhurat nga qiraja - Linjat e dhëna me qira

Shoqëria jep me qira linja kryesisht operatorëve mobile në mënyre që rrjeti i tyre të lidhet me rrjetin fiks të Albtelekom Sh.a. Të ardhurat fikse të qirase për këto linja njihen në bazë të metodës lineare mbi kushtet kontraktuale të qirasë. Të ardhurat nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës lineare sipas kohezgjatjes së qirasë.

Të ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshëm mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përllogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.13 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 eshte 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të paguesheëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.
Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.14 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shendetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.15 Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.16 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishem në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Toka Ndërtesa	Linja dhe paisje të telekomunikacionit	Makineri e paisje	Mjete Transporti	Paisje zyre e informatike	Aktive në proces	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2020	6,871,447	13,356,484	8,366,296	182,995	3,155,295	118,621	32,051,138
Shtesa	186,795	-	171,707	-	269,001	541,484	1,168,987
Nxjerrje jashtë përdorimit	(25,683)	(16,625)	-	-	(24,276)	-	(66,584)
Pakësime	(329,213)	-	-	(16,885)	(82)	-	(346,180)
Rivlerësime	(260,741)	-	(4,021,212)	-	-	-	(4,281,953)
Transferime	8,674	213,615	6,784	-	95,460	(344,699)	(20,166)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	6,451,279	13,553,474	4,523,575	166,110	3,495,398	315,406	28,505,242
Shtesa	-	-	96,164	-	177,528	412,638	686,330
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(1,734)	-	(1,734)
Pakesime	-	-	(2,505)	(5,834)	(21,801)	-	(30,140)
Rivlerësime	-	(1,631,347)	-	-	-	-	(1,631,347)
Transferime	41,554	121,685	178,840	-	139,124	(481,788)	(585)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	6,492,833	12,043,812	4,796,074	160,276	3,788,515	246,256	27,527,766
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2020	2,288,020	1,126,900	4,237,810	136,520	2,264,940	-	10,054,190
Amortizimi i vitit	137,283	369,948	606,808	9,156	236,875	-	1,360,070
Rivlerësime	(217,862)	-	(3,977,116)	-	-	-	(4,194,978)
Nxjerrje jashtë përdorimit	(9,703)	(1,023)	-	-	(8,436)	-	(19,162)
Pakësime	(1,646)	-	-	(15,893)	(42)	-	(17,581)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,196,092	1,495,825	867,502	129,783	2,493,337	-	7,182,539
Amortizimi i vitit	127,990	359,788	558,565	7,203	265,055		1,318,601
Rivlerësime	-	(1,495,822)	-	-	-	-	(1,495,822)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(8,752)	-	(8,752)
Pakësime	-	-	(535)	(5,467)	(1,442)	-	(7,444)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,324,082	359,791	1,425,532	131,519	2,748,198	-	6,989,122
Zhvlerësimi i AAM-ve							
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	-	504	361	9,526	2,502	12,893
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	-	504	361	9,526	2,502	12,893
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,255,187	12,057,649	3,655,569	35,966	992,535	312,904	21,309,810
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,168,751	11,684,021	3,370,038	28,396	1,030,791	243,754	20,525,751

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Shoqëria vlerëson aktivet e saj me vlerën e drejtë siç përshkruhet në shënimin 4.5 të këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria ka kryer rivlerësimin e pare të aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2008.

Më 1 janar 2020 shoqëria ka kryer rivlerësimin e grupit të "Makineri dhe paisje".
Ndërsa më 1 janar 2021, shoqëria ka kryer rivlerësimin me vlerën e drejtë grupit të "Linjave dhe paisje te telekomunikacionit", bazuar në vlerësimin e bërë nga ekspertë vlerësues.
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkojnë kryerjen e rivlerësimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale periodikisht çdo 3 ose 5 vjet në rast se ekzistojnë tregues që vlera e drejtë e këtyre aktiveve ka ndryshime të rëndësishme nga vlera e mbartur e tyre.

Manaxhimi ka gjykuar se nuk ekzistojnë tregues që vlera e drejtë e aktiveve afatgjata materiale ka ndryshime të rëndësishme për grupin e makineri paisjeve , për shkak të futjes së teknologjisë së re dhe zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale, si dhe të kompatibilitetit të teknologjisë së futur rishtazi me atë ekzistuese.

6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin 2021 janë si më poshtë:

	Licenca dhe të tjera	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	3,978,728	3,978,728
Transferime	20,166	20,166
Gjendja më 31 dhjetor 2020	3,998,894	3,998,894
Shtesa	6,298	6,298
Transferime	586	586
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,005,778	4,005,778
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	1,584,978	1,584,978
Amortizimi i vitit	225,246	225,246
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,810,224	1,810,224
Amortizimi i vitit	218,895	218,895
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,029,119	2,029,119
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2020	2,188,670	2,188,670
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2021	1,976,659	1,976,659

7. AKTIVET NË PËRDORIM

Lëvizjet e aktiveve në përdorim për vitin 2021 janë si më poshtë:

	Ndërtesa	Objekte	Fiber e zeze	TOTAL
E drejta e përdorimit (aset):				
Gjendja më 1 janar 2020	1,930,208	926,560	9,738	2,866,506
Shtesa	37,188	-	20,904	58,092
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,967,396	926,560	30,642	2,924,598
Shtesa	636,995	62,516	3,306	702,817
Transferime	204,449	-	-	204,449
Nxjerrje jashtë përdorimit	(348,058)	-	-	(348,058)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,460,782	989,076	33,948	3,483,806
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2020	82,654	177,029	6,262	265,945
Shtesa	92,548	178,900	6,615	278,063
Nxjerrje jashtë përdorimit	(3,045)	-	-	(3,045)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	172,157	355,929	12,877	540,963
Shtesa	148,194	184,018	7,105	339,317
Transferime	69,420	-	-	69,420
Nxjerrje jashtë përdorimit	(79,048)	(3,786)	-	(82,834)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	310,723	536,161	19,982	866,866
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,795,239	570,631	17,765	2,383,635
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,150,059	452,915	13,966	2,616,940

8. AKTIVET INVESTUESE

Lëvizjet e aktiveve investuese për vitin 2021 janë si më poshtë:

	Ndërtesa	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2020	224,102	224,102
Shtesa	1,030	1,030
Pakësime	(20,683)	(20,683)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**204,449**	**204,449**
Shtesa		-
Transferime	(204,449)	(204,449)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**-**	**-**
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2020	30,140	30,140
Amortizimi i vitit	42,616	42,616
Pakësime	(3,336)	(3,336)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**69,420**	**69,420**
Amortizimi i vitit	-	-
Transferime	(69,420)	(69,420)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**-**	**-**
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2020	**135,029**	**135,029**
Gjendja Neto me 30 shtator 2021	**-**	**-**

9. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA

Në zërin "Kredi të dhëna" pasqyrohet kredia e dhënë punonjësve për banesa e cila vazhdon të shlyhet mbi bazën e kontratave 20 -25 vjeçare duke filluar nga vitit 1997.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kredi të dhëna personelit	19,467	22,360
	19,467	22,360

10. INVENTARI

Gjendjet e inventarit janë të analizuara si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Materiale të para	336,639	428,861
Produkte e mallra	364,287	425,968
Të tjera gjendje inventari	18,289	15,791
Zhvlerësimi për inventare	(405,324)	(324,491)
	313,891	546,129

10. INVENTARI (VAZHDIM)

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 Janar	324,491	275,464
Shtesa provizione	80,833	49,027
Gjendja më 31 dhjetor	**405,324**	**324,491**

11. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATSHKURTRA

Në përgjithësi, llogaritë e arkëtueshme dhe zhvlerësimi i tyre është i detajuar si më poshtë:

11.1 Analiza e llogarive të arkëtueshme

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë për shitje e shërbime	3,112,121	3,058,920
Zhvlerësimi i kërkesave për arkëtim	(2,270,101)	(2,296,306)
Neto llogari të arkëtueshme tregtare	**842,020**	**762,614**
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	267,933	266,442
Zhvlerësimi i të tjerave të arkëtueshme	(194,023)	(185,949)
Neto llogari të tjera të arkëtueshme	**73,910**	**80,493**
Totali	**915,930**	**843,107**

11.2 Llogaritë e arkëtueshme ndaj klientëve

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë për trafikun kombëtar		
Abonentë Familjarë	833,841	813,824
Abonentët biznes	1,127,763	1,019,224
Minus Zhvlerësimi	(1,457,469)	(1,343,440)
Klientë për trafikun ndërkombëtar	480,343	483,699
Minus Zhvlerësimi	(335,876)	(322,666)
Operatorë Internet dhe qira linjash	464,006	623,329
Distrubutorët e Kartave	169,120	85,092
Klientë të tjerë	37,048	33,752
Minus Zhvlerësimi	(476,756)	(630,200)
	842,020	762,614

11. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA (VAZHDIM)

11.3 Provizionet për zhvlerësim për kërkesat për arkëtim

Gjatë vitit 2021 në llogaritë e provizioneve për zhvlerësimin e kërkesave për arkëtim, kanë ndodhur lëvizjet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	2,482,255	2,748,585
Shtesa provizione	38,651	497
Rimarrje për vitin	(56,782)	(266,827)
Gjendja më 31 dhjetor	**2,464,124**	**2,482,255**

11.4 Të tjera llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagim Detyrimi sipas akt kont gjoba dhe interesa	208,393	208,393
Të tjera kerkesa	59,540	58,049
Minus Zhvlerësimi kërkesa të tjera	(194,023)	(185,949)
	73,910	80,493

12. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Balanca e parapagimive dhe shpenzimeve të shtyra paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime të shtyra afatshkurtra	*48,022*	*62,269*
Shpenzime të shtyra afatgjata	*19,335*	*15,455*
Total Shpenzime të shtyra	67,357	77,724
Parapagime për furnitorët Afatgjata	43,940	99,810
Totali parapagime dhe shpenzime të shtyra	111,297	177,534

13. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në arkë	27	56
Llogari rrjedhëse	76,668	60,214
Para në udhëtim	75,537	10,770
	152,232	71,040

13. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË (VAZHDIM)

Detaje të mëtejshme të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj sipas monedhës:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në bankë	76,668	60,214
në USD	90	1,083
në EURO	10,098	3,233
në LEK	66,442	55,774
në GBP	37	121
në TRY	1	3
Mjete monetare në arkë	27	56
në LEK	27	56
Para në udhëtim	75,537	10,770
	152,232	71,040

14. KAPITALI AKSIONAR

Struktura dhe shuma e kapitalit është si më poshtë :

	2021			2020		
	%	Nr. i Aksioneve	Kapitali i Nënshkruar	%	Nr. i Aksioneve	Kapitali i Nënshkruar
METE	13.78%	2,515,255	2,515,255	13.78%	2,515,255	2,515,255
Posta Shqiptare	2.47%	450,000	450,000	2.47%	450,000	450,000
Aksionar të tjerë (individë)	3.48%	634,745	634,745	3.48%	634,745	634,745
CETEL	80.27%	14,650,000	14,650,000	80.27%	14,650,000	14,650,000
Total	100.00%	18,250,000	18,250,000	100.00%	18,250,000	18,250,000

15. HUATË

Huatë paraqiten të detajuara më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020:

	Monedha	Principali i mbetur i Huasë në monedhë	Interesi në %	Shuma Ekuivalente Në 000/Leke	Shuma Deri në 1 Vit	Shuma mbi 1 Vit
Aktif Bank	EUR	43,206	5.00%	5,217,599	-	5,217,599
Calik Holding	EUR	30,252	5.48%	3,653,259	-	3,653,259
BKT 1	ALL	2,787,969	4.00%	2,787,969	174,000	2,613,969
BKT 2	ALL	783,219	4.00%	783,219	48,000	735,219
BKT 3	ALL	267,415	4.00%	267,415	28,703	238,712
BKT 4	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 5	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	-
BKT 6	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 7	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	-
BKT 8	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 9	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	
Italian Government	EUR	1,324	1.00%	159,877	45,679	114,198
Tirana Bank Overdraft 1	EUR	341	4.75%	41,205	41,205	-
Tirana Bank Overdraft 2	ALL	396,447	5.50%	396,447	396,447	-
Raiffeisen Bank Overdraft 1	EUR	1,000	5.30%	120,760	120,760	-
Raiffeisen Bank Overdraft 2	EUR	500	5.50%	60,380	60,380	-
Raiffeisen Bank Overdraft 3	EUR	150	5.30%	18,114	18,114	-
Raiffeisen Bank 1	EUR	458	5.30%	55,348	30,190	25,158
Raiffeisen Bank 2	EUR	500	5.30%	60,380	24,152	36,228
Raiffeisen Leasing	EUR	23	E12M+4%,jo më pak se 4%	2,777	2,777	-
Interesa Maturuara	ALL			422,828	422,828	-
Total 31 dhjetor 2021				14,269,577	1,635,235	12,634,342

15. HUATË (VAZHDIM)

	Monedha	Principali i mbetur i Huasë në monedhë	Interesi në %	Shuma Ekuivalente Në 000/Leke	Shuma Deri në 1 Vit	Shuma mbi 1 Vit
Aktif Bank	EUR	43,206	5.75%	5,344,625	-	5,344,625
Calik Holding	EUR	29,952	5.10%	3,705,091	-	3,705,091
BKT 1	ALL	2,961,969	5.00%	2,961,969	174,000	2,787,969
BKT 2	ALL	831,219	5.00%	831,219	48,000	783,219
BKT Kosovo	EUR	2,347	6.50%	290,287	17,505	272,782
Italian Government	EUR	1,702	1.00%	210,561	46,791	163,770
Tirana Bank Overdraft 1	EUR	406	4.75%	50,173	50,173	-
Tirana Bank Overdraft 2	ALL	401,673	5.50%	401,673	401,673	-
Raiffeisen Bank Overdraft 1	EUR	1,000	5.30%	123,700	123,700	-
Raiffeisen Bank Overdraft 2	EUR	250	5.50%	30,925	30,925	-
Raiffeisen Bank	EUR	708	5.30%	86,648	30,925	55,723
Raiffeisen Leasing	EUR	49	E12M+4%,jo më pak se 4%	6,122	3,284	2,838
Tirana Facotring and lease	EUR	3	7.50%	369	369	-
Interesa Maturuara	ALL	-		184,074	184,074	-
Total 31 dhjetor 2020				14,227,436	1,111,419	13,116,017

Kompania ka vendosur si kolateral për kreditë nga BKT, Raiffeisen dhe Tirana Bank disa ndërtesa në zotërim.

16. QIRAJA FINANCIARE

Qiraja financiare ndahet në afatshkurtër dhe afatgjatë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	471,344	356,690
Detyrimet afatgjatë të qirasë	2,467,007	2,234,999
	2,938,351	2,591,689

Shuma të njohura në të ardhura e shpenzime

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime amortizimi te aktiveve me te drejta ne perdorim	339,316	251,259
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	143,739	130,127
Shpenzime qeraje që lidhen me qira afatshkurtra	-	69,421
Shpenzimet që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët	1,794	995
Shpenzimi në lidhje me pagesat e qirasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë	24,375	7,841
	509,224	459,643

Analiza e maturitetit.

Flukset kontraktuale te paskontuara paraqiten si mëposhtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Deri në 1 vit	471,344	356,690
1 - 5 vite	639,198	829,946
mbi 5 vite	1,849,724	2,881,136
Detyrimi i qirasë i paskontuar më 31 dhjetor	2,960,266	4,067,772

17. PROVIZIONET

Lëvizjet e provizioneve për rreziqe paraqiten si vijon:

Afatshkurtër:	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	49,383	49,383
Shtesa provizione	-	
	49,383	49,383

Afatgjatë:	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	98,200	55,263
Shtesa provizione	-	42,937
	98,200	98,200

18. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare ndahen në afatshkurtra dhe afatgjata si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të pagueshme tregtare afatgjata	-	160,085
Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra	2,190,359	2,749,945
	2,190,359	2,910,030

Llogaritë e pagueshme detajohen më tej:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
MAKHES ALBANIA	271,333	283,548
CALIK HOLDING A.S	253,318	186,911
GOGEL shpk	185,158	87,988
OKTAPUS shpk	195,177	157,792
Bayerische Landesbank	130,884	241,327
DIGIT ALB sha	83,320	49,639
Telekom Slovenije d.d.	71,930	73,673
TRING TV SH.A.	55,504	46,066
Hua Ying Management Co. Limite	51,573	236,721
Furnitore te tjere	892,162	1,546,365
	2,190,359	2,910,030

19. GRANTET, TË ARDHURAT E SHTYRA DHE DETYRIME TË TJERA

Grantet përfaqësojnë pajisje telekomunikacioni ndërsa të ardhurat e shtyra për kohë të pakonsumuar përfaqësojnë kohë bisede të pakonsumuar të kartave rimbushëse të shitura në fund të vitit.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Grante	57,623	72,611
Të ardhura të shtyra për kohë të pakonsumuar	69,874	69,797
Të ardhura të shtyra nga kontrata me klientet	239,133	244,549
	366,630	386,957

20. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Detyrimet të tjera afatshkurtra të shoqërisë janë të analizuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Personeli	129	132
Sigurime shoqërore	17,162	17,565
Shteti tatime e taksa	68,607	64,730
Të tjera detyrime	30,751	29,078
	116,649	111,505

Detyrimet ndaj punonjësve

Marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë me punonjësit e tyre bazohen në kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata kolektive e punës është lidhur ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj për përcaktimin e detyrimeve reciproke që lindin nga marrëdhënia e punës.
Sipas legjislacionit të punës në fuqi, shoqëria mund të penalizohet deri në 15 paga mujore në rast të një ndërpreje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të marrëdhënies së punës me punonjësin e saj.
Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë provizion lidhur me kostot e mundshme nga ndërprerja e menjëhershme dhe e pa justifikuar e kontratave të punës me punonjësit e saj.

Numri mesatar i personelit sipas funksioneve është si vijon:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Drejtorë, Manaxherë e drejtues departamenti	101	100
Specialistë	595	629
Personel teknik	37	39
Punëtorë	3	20
Stafi ndihmës	17	7
	753	795

Shteti tatim e taksa

Shteti tatim e taksa analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
TVSH për t'u paguar	46,845	31,896
Tatim mbi të ardhurat personale	8,755	13,547
Tatimi në burim	13,007	19,287
	68,607	64,730

21. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shërbimi telefonik kombëtar fix	2,336,609	2,628,574
Shërbimi telefonik kombëtar mobile	2,098,765	2,288,994
Shërb. telefonik ndërkombetar	575,787	539,805
Shërbimi Roaming	108,890	53,683
Shërbimi interkoneksionit ndaj operatorëve	737,830	696,813
Internet, ADSL, ISDN, LAN,internet IP	798,434	716,770
Shërbimet e instalimit	21,679	30,342
Linjat dhe qarqet me qera	111,234	109,072
Të ardhura të tjera	2,377	2,868
Shërbimi i kartës së parapaguar	54	108
Total të ardhura nga veprimtaria kryesore	6,791,659	7,067,029
Nga modem dhe ADSL, Sim Card dhe të tjera	31,650	32,642
Shitje aparati telefonik	1,946	2,253
Sistemim i IFRS 15	(4,242)	(8,629)
Aksesorë	160	205
Total shitje	29,514	26,471
Te ardhura nga qiraja	79,377	76,760
Te ardhura nga sherbime per fix	2,980	2,619
Te tjera	19,863	16,506
Te ardhura te tjera	102,220	95,885
Total shitje neto	6,923,393	7,189,385

22. SHPENZIMET

Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e ndara sipas natyrës dhe funksionit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile AMC	227,650	-	-	227,650
Operatorët Mobile Vodafon	337,583	-	-	337,583
Operatorët Rurale/alternativë	8,958	-	-	8,958
Operatorë të tjerë (vas)	392	-	-	392
Operatorët Ndërkombëtarë	543,892	-	-	543,892
Shpenzime Interneti	218,057	-	-	218,057
Licensa	184,220	-	-	184,220
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	11,136	8,444	19,580
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	610,012	8,148	74,524	692,684
Shpenzime Qeraje	2,258	15,396	8,515	26,169
Rojet e Objekteve	-	-	29,618	29,618
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	5,426	-	14,962	20,388
Reklamë e Publicitet	-	192,144	-	192,144
Marredhenie me Publikun	-	11,360	-	11,360
Udhëtime e Dieta	-	-	14,013	14,013
Ujë dhe Energji elektrike	255,049	-	32,839	287,888
Komisionet Bankare	-	-	3,060	3,060
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	449,949	171,499	124,587	746,035
Shpenzime për Materiale	41,408	4,219	34,658	80,285
Shpenzime për Mallra	16,783	1,695	19	18,497
Tatime e taksa	-	-	27,010	27,010
Pagat	101,468	307,073	396,943	805,484
Trajtime dhe shpërblime të tjera	52,268	60,077	111,847	224,192
Sigurime shoqërore	47,500	46,508	31,627	125,635
Amortizimi	1,440,973	224,861	195,972	1,861,806
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	-	-	27,948	27,948
Zhvleresim i Inventarit	-	-	81,289	81,289
Shpenzime borxh i keq	-	-	4,780	4,780
Shpenzime të tjera rrjedhëse	48,135	2,308	63,938	114,381
Totali per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	4,591,981	1,056,424	1,286,593	6,934,998

21. SHPENZIMET (VAZHDIM)

	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile AMC	224,958	-	-	224,958
Operatorët Mobile Vodafon	385,296	-	-	385,296
Operatorët Rurale/alternativë	15,826	-	-	15,826
Operatorë të tjerë (vas)	418	-	-	418
Operatorët Ndërkombëtarë	383,329	-	-	383,329
Shpenzime Interneti	176,853	-	-	176,853
Licensa	191,189	-	-	191,189
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	13,138	17,047	30,185
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	518,862	7,335	65,765	591,962
Shpenzime Qeraje	1,175	14,422	2,852	18,449
Shpenzime Qeraje nga aplikimi I IFRS 16	-	-	-	-
Rojet e Objekteve	-	-	32,259	32,259
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	8,644	-	15,601	24,245
Reklamë e Publicitet	-	353,917	-	353,917
Marredhenie me Publikun	-	9,445	-	9,445
Udhëtime e Dieta	-	-	16,830	16,830
Ujë dhe Energji elektrike	251,740	-	37,627	289,367
Komisionet Bankare	-	-	3,510	3,510
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	519,066	176,280	147,822	843,168
Shpenzime për Materiale	53,503	4,353	44,623	102,479
Shpenzime për Malira	17,493	5,552	47	23,092
Tatime e taksa	-	-	22,404	22,404
Pagat	291,207	259,930	310,650	861,787
Trajtime dhe shpërblime të tjera	68,728	69,554	154,889	293,171
Sigurime shoqërore	46,121	47,560	32,912	126,593
Amortizimi	1,507,311	213,580	166,357	1,887,248
Zhvleresim I inventarit	-	-	49,027	49,027
Shpenzime borxh i keq	-	-	3,893	3,893
Shpenzime per provizione	-	-	42,937	42,937
Shpenzime të tjera rrjedhëse	14,742	1,205	55,581	71,528
Totali per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	**4,676,461**	**1,176,271**	**1,222,633**	**7,075,365**

25. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin është përllogaritur si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	(539,879)	(1,175,245)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	370,884	534,608
Shpenzime borxh i keq	27,948	3,893
Provizione	81,289	91,964
Shpenzime per interesa	100,071	256,585
Amortizimi tej normave të lejuara me ligj	-	2,349
Humbje nga shitja e aseteve	-	19,819
Amortizimi fiscal	(25,570)	(34,586)
Të ardhura të patatueshme të periudhave të mëparshme nga IFRS 15	4,242	8,629
Shpenzime amortizimi dhe qiraje nga IFRS 16	59,121	59,029
Shpenzime të tjera	123,783	126,926
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(168,995)	(640,637)
Tatim fitimi @15%	-	-
Fitimi /(Humbja) e vitit	(539,879)	(1,175,245)

Lëvizjet e tatim fitimit për vitin 2021 janë si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	57,130	(55,053)
Tatim fitimi i parapaguar	23,691	112,183
Total	80,821	57,130

Tatimi i shtyrë e llogaritur për vitin 2021 ka të bëjë me sa vijon:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	990,958	1,034,405
Efekti në pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me normën e tatimit fitimit të vitit actual	(16,550)	(43,447)
Total	974,408	990,958

26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqëritë nën të njëjtin kontroll, me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.
Vlerat e paraqitura në seksionin a aktiveve me palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	3,333	4,123
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	8,897	3,275
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	4	4
Punonjësit e Albtelecom	1,275	1,425
Posta Shqiptare	56,128	57,615
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	2,146
Total llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	**69,637**	**68,588**

Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	3,542	13
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	47,180	37,382
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	67
Total mjete monetare pranë palëve të lidhura	**50,722**	**37,462**

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Çalık Holding A.Ş.	257,873	186,911
Akılcı Bilişim Çözümleri ve Da	5,292	-
CETEL TELEKOM ILETISIM A.S	6,751	-
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	1,099	576
Posta Shqiptare	1,845	44,101
Total llogari të pagueshme me palë të lidhura	**272,860**	**231,588**

Huatë me palët e lidhura detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	5,284,993	5,344,625
Çalık Holding A.Ş.	4,003,187	3,880,771
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	4,064,366	3,797,402
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	291,833
Total hua me palët e lidhura	**13,352,546**	**13,314,631**

26. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Shitjet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si mëposhtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	185,838	125,027
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	6,238	1,082
Posta Shqiptare	14,868	14,189
Total	**206,944**	**140,298**

Blerjet gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	292,635	398,058
Banka Kombetare Tregtare Sh.a (shpenzime financiare)	165,514	189,514
Banka Kombetare Tregtare Sh.a (shpenzime të tjera)	6,330	22,470
Banka Kombetare Tregtare Sh.a (shpenzime administrative)	12,790	-
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	13,654	19,403
CETEL TELEKOM ILETISIM A.S	9,227	-
Çalık Holding AŞ (shpenzime financiare)	201,006	162,350
Çalık Holding AŞ (shpenzime të tjera)	10,827	-
Çalık Holding AŞ (shpenzime administrative)	65,614	86,246
Posta Shqiptare	3,592	3,189
Total	**781,189**	**881,230**

Shpërblimet e drejtorëve të përfshira në shpenzimet e Shoqërisë për vitin janë si me poshtë:

	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga, shpërblime të organeve drejtuese	156,396	157,711
Paga, shpërblime të anetareve te bordit mbikqyres	27,388	37,020
Total	**183,784**	**194,731**

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i likuiditetit, risku nga interesi, risku nga monedhat e huaja dhe risku i kreditit. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.
Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërisë fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqërisë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiare krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

27.1 Risku i Likuiditeteve

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndërtuar bazuar në maturitete kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

	31 dhjetor 2021			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	710,990	93,983	2,575,081	3,380,054
Mjete monetare në arkë dhe bankë	152,232	-	-	152,232
Totali	**863,222**	**93,983**	**2,575,081**	**3,532,286**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,226,026)	(80,982)	-	(2,307,008)
Hua	(1,111,356)	(523,879)	(12,634,342)	(14,269,577)
Totali	**(3,337,382)**	**(604,861)**	**(12,634,342)**	**(16,576,585)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2021	**(2,474,160)**	**(510,878)**	**(10,059,261)**	**(13,044,299)**

	31 dhjetor 2020			
Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	909,460	78,254	2,337,648	3,325,362
Mjete monetare në arkë dhe bankë	71,040			71,040
Totali	**980,500**	**78,254**	**2,337,648**	**3,396,402**
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,781,407)	(80,043)	(160,085)	(3,021,535)
Hua	(377,395)	(734,024)	(13,116,017)	(14,227,436)
Totali	**(3,158,802)**	**(814,067)**	**(13,276,102)**	**(17,248,971)**
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	**(2,178,302)**	**(735,813)**	**(10,938,454)**	**(13,852,569)**

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.2 Risku i normave të interesit

Të ardhurat si dhe rrjedhja e parave nga aktiviteti i shfrytëzimit i shoqërisë ndikohen nga përqindjet e interesit. Shoqëria ka marrë hua afatgjatë me interes të ndryshueshëm dhe me interes fiks. Shoqëria përballet me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me riskun e normave të interesit të çdo depozite afatshkurtër.

Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.
Detajimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Instrumenta me interest fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	5,377,476	5,555,928
	5,377,476	5,555,928
Instrumenta me interest variable		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	8,892,101	8,671,508
	8,892,101	8,671,508

27.3 Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

Më 31 dhjetor 2021 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	152,012	371,993	2,814,868	41,181	3,380,054
Mjete monetare në arkë dhe bankë	73,178	90	78,954	10	152,232
Totali	225,190	372,083	2,893,822	41,191	3,532,286
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,562,727)	(32,680)	(701,009)	(10,592)	(2,307,008)
Hua	(9,455,147)		(4,814,430)		(14,269,577)
Totali	(11,017,874)	(32,680)	(5,515,439)	(10,592)	(16,576,585)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2021	(10,792,684)	339,403	(2,621,617)	30,599	(13,044,299)

27. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.3 Risku nga monedhat e huaja (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020 Balancat në monedhë të huaj detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020				
Përshkrimi	EUR	USD	ALL	Të tjera	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	227,985	352,951	2,579,905	164,521	3,325,362
Mjete monetare në arkë dhe bankë	59	1,083	69,821	77	71,040
Totali	228,044	354,034	2,649,726	164,598	3,396,402
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,872,494)	(59,066)	(1,079,046)	(10,929)	(3,021,535)
Hua	(10,027,384)		(4,200,052)		(14,227,436)
Totali	(11,899,878)	(59,066)	(5,279,098)	(10,929)	(17,248,971)
Rrezlku i monedhës më 31 dhjetor 2020	(11,671,834)	294,968	(2,629,372)	153,669	(13,852,569)

27.4 Risku i kreditit

Politika e shoqërisë stimulon klientët të konsumojnë shërbimin në avancë kundrejt pagesës së mëvonshme. Ndërkohë balanca e llogarive të arkëtueshme monitorohet në vazhdimësi në mënyrë që rezultati i ekspozimit të shoqërisë ndaj borxheve të këqija të mos jetë i konsiderueshëm.
Testi i vlerës së llogarive të arkëtueshme kryhet në çdo datë raportimi në baza individuale për klientët e mëdhenj. Klientët e vegjël grupohen në grupe homogjene dhe testohen në mënyrë kolektive.
Tabela më poshte paraqet aktivet financiare për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të arkëtueshme tregtare	842,020	762,614
Llogari të arkëtueshme të tjera	73,910	80,493
Mjete monetare	152,232	71,040
	1,068,162	914,147

Detaje mbi moshën e të arkëtueshmeve dhe zhvlerësimin e tyre paraqiten në shënimin 12 të pasqyrave financiare.

28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Angazhimet vjetore për qira operative janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Brenda një viti	14,631	3,734
1 - 5 vite	9,299	3,946
Me shume se 5 vjet	-	-
	23,930	7,680

Shoqëria është e përfshirë në çështje gjyqësore të ndryshme gjatë rrjedhës normale të biznesit. Në gjykimin e manaxhimit rezultati final i këtyre çështjeve nuk do të ketë një impakt material në rezultatin aktual të shoqërisë.

29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më datë 8 dhjetor 2021, CETEL TELEKOM, në cilësinë e shitësit dhe 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG, një kompani e themeluar sipas ligjeve të Hungarisë, ("4IG" ose "Blerësi"), në cilësinë e blerësit, kanë nënshkruar një kontratë për shitblerje aksionesh me anë të së cilës CETEL TELEKOM i shet 4IG pjesëmarrjen e saj në kapitalin e Shoqërise e cila përbën 80,27% të të gjithë kapitalit aksionar të Shoqërisë

Kjo kontratë është një kontratë me kusht, e cila parashikon zbatimin e disa kushteve paraprake në mënyrë që të bëhet efektiv transferimi i 80,27% të aksioneve të shoqërisë nga CETEL TELEKOM tek aksioneri i ri 4IG. Afati për përmbushjen e kushteve paraprake ishte parashikuar 6 muaj nga nënshkrimi i saj.

Si pjesë e kushteve paraprake është marrë një autorizim nga organet rregullatore si AKEP, AMA dhe Autoriteti i Konkurrencës.
Në datën 04.03.2022, kur të gjitha kushtet paraprake u përmbushën, në përputhje me përcaktimet e kontratës së datës 08.12.21, palët nënshkruan marrëveshjen përfundimtare të transferimit të aksioneve nga CETEL TELEKOM te Blerësi ("Marrëveshja e Transferimit").

Që nga data 31 dhjetor 2021, data e këtyre pasqyrave financiare, dhe deri në datën e miratimit të tyre, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje tjetër e mëpasshme që të jetë materialisht e rëndësishme për t'u paraqitur në pasqyrat financiare.

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al

ALBtelecom sh.a.
NR. 4531 PROT.
DATË 16.8.2022

Albtelecom sh.a

Pasqyrat Financiare të Ndërmjetme të Përmbledhura më dhe për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E POZICIONIT FINANCIAR 2
PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E FITIMIT OSE HUMBJES 3
PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE 4
PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE 5
PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA 6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA 7

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM 7
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA 7
3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR 10
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL 11
5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE 23
6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE 24
7. AKTIVET NË PËRDORIM 25
8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA 26
9. INVENTARI 26
10. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATSHKURTRA 26
11. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA 28
12. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË 28
13. KAPITALI AKSIONAR 29
14. HUATË 30
15. QIRAJA FINANCIARE 32
16. PROVIZIONET 32
17. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE 33
18. GRANTET, TË ARDHURAT E SHTYRA DHE DETYRIME TË TJERA 33
19. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA 34
20. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT 35
21. SHPENZIMET 36
22. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT 38
23. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE 38
24. TATIMI MBI FITIMIN 39
25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA 40
26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT 42

mazars

Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania

Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT MBI RISHIKIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Albtelecom sh.a

Parashtrim

Ne kemi rishikuar pasqyrën e ndërmjetme të përmbledhur të pozicionit financiar të **Albtelecom sh.a** më datën 30 qershor 2022, pasqyrën e ndërmjetme të përmbledhur të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën gjashtë mujore që mbyllet në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare të ndërmjetme ("pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura"). Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura në përputhje me SNK 34 "Raportimi Financiar i Ndërmjetëm". Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion mbi këto pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura bazuar në rishikimin tonë.

Objekti i Rishikimit

Ne e kryem rishikimin tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Angazhimet e Rishikimeve 2410, "Rishikim i Informacionit Financiar të Ndërmjetëm të kryer nga Audituesi i Pavarur i Shoqërisë". Një rishikim i pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura konsiston në zhvillimin e takimeve dhe pyetësorëve, fillimisht me personat përgjegjës për çështjet financiare dhe kontabël, si dhe performimin e procedurave analitike dhe të tjera rishikimi. Një rishikim është në thelb më i vogël në objekt sesa një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe rrjedhimisht nuk na mundëson marrjen e sigurisë që do të jemi në dijeni të të gjitha çështjeve të rëndësishme që mund të identifikohen në një audit. Në përputhje me rrethanat, ne nuk shprehim një opinion auditimi.

Konkluzioni

Bazuar në rishikimin tonë, asgjë nuk na ka tërhequr vëmendjen që të na bëjë të besojmë se pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura shoqëruese më dhe për gjashtëmujorin e përfunduar më 30 qershor 2022 nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me SNK 34, "Raportimi Financiar i Ndërmjetëm".

13 shtator 2022

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

Mazars shpk
K32123006W

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E POZICIONIT FINANCIAR
Më 30 qershor 2022
(000/Lekë)

	Shënime	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	20,208,352	20,525,751
Aktivet afatgjata jomateriale	6	1,877,467	1,976,659
Asete ne perdorim	7	1,095,045	2,616,940
Të tjera llogari të arkëtueshme afatgjata	8	18,380	19,467
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	85,033	19,335
Totali i aktiveve afatgjata		23,284,277	25,158,152
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	9	331,544	313,891
Llogari të arkëtueshme tregtare afatshkurtra	10	777,460	842,020
Tatim fitimi i parapaguar	24	67,018	80,821
Llogari të arkëtueshme të tjera afatshkurtra	10	78,094	73,910
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	120,610	91,962
Mjetet monetare në arkë e në bankë	12	109,043	152,232
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,483,769	1,554,836
Totali i aktiveve		24,768,046	26,712,988
KAPITALI			
Kapitali themeltar		18,250,000	18,250,000
Rezerva rivlerësimi		2,574,133	2,574,133
Rezerva te ligjore		232,302	232,302
Fitime/humbje të mbartura		(15,401,928)	(15,347,004)
Totali i kapitalit	13	5,654,507	5,709,431
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	14	12,842,211	12,634,342
Qira financiare	15	870,000	2,467,007
Provizione	16	98,200	98,200
Llogari te pagueshme afatgjata	17	-	-
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	18	276,982	296,756
Tatim fitimi i shtyre mbi fitimin	24	946,903	974,408
Totali i detyrimeve afatgjata		15,034,296	16,470,713
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	14	1,262,327	1,635,235
Qira financiare	15	527,977	471,344
Llogari të pagueshme tregtare	17	1,775,632	2,190,359
Provizione	16	81,549	49,383
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	18	54,957	69,874
Llogari të pagueshme të tjera	19	376,801	116,649
Totali i detyrimeve afatshkurtra		4,079,243	4,532,844
Totali i detyrimeve		19,113,539	21,003,557
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		24,768,046	26,712,988

Shënimet shpjeguese në faqet 7-42 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E FITIMIT OSE HUMBJES
Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022
(000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022	Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	3,281,079	3,306,353
Kosto e sherbimeve te shitura	21	(2,204,621)	(2,348,641)
Total të ardhura		**1,076,458**	**957,712**
Shpenzimet e shitjes dhe te shperndarjes	21	(453,811)	(496,194)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	21	(530,231)	(572,262)
Te ardhura/shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	22	92,043	6,388
Fitimi operativ		**184,459**	**(104,356)**
Interesa/ (shpenzime) per interesa	23	(403,065)	(440,020)
Te ardhura/shpenzime financiare neto	23	149,971	116,456
Fitimi/humbja para tatimit		**(68,635)**	**(427,920)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	**(13,803)**	**-**
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(13,803)	
Fitimi/humbja e vitit		**(82,438)**	**(427,920)**

Shënimet shpjeguese në faqet 7-42 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura.

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022
(000/Lekë)

	Për vitin e mbyllur me 30 qershor 2022	Për vitin e mbyllur me 30 qershor 2021
Fitimi/humbja e vitit	(82,438)	(427,920)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
Zëra që mund të riklasifikohen më vonë ne fitim/humbje:		
Zëra që nuk do të riklasifikohen më vonë ne fitim/humbje:		
Tatimi fitimi i shtyrë që regjistrohetdirekt ne te ardhura te tjera gjitheperfshirese	27,514	(1,054)
Rivlerësimi makineri e pajisjeve	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	**27,514**	**(1,054)**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	**(54,924)**	**(428,974)**

Shënimet shpjeguese në faqet 7-42 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura.

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE
Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022 (000/Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022	Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		**(68,635)**	**(427,920)**
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Amortizimi		886,187	923,652
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital		71	(608)
Zhvlerësimi I llogarive te arketueshme		42,594	-
Zhvlerësimi i inventarit		(12,604)	-
Provizione		32,166	-
Shpenzime për interesa		335,823	379,694
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Rënie/(rritje) në inventar		(5,049)	146,387
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(75,477)	(51,927)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		(189,257)	(23,796)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**945,819**	**945,482**
Interesa të paguara			
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit			(23,691)
Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative		**945,819**	**921,791**
Aktivitetet investuese			
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(308,330)	(382,708)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		19	623
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(308,311)**	**(382,085)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata		207,869	(183,819)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër		(708,731)	(162,998)
(Ripagim)/ të hyra nga qerate financiare		(179,835)	(115,330)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**(680,697)**	**(462,147)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**(43,189)**	**77,559**
Mjetet monetare në fillim të periudhës		152,232	71,040
Mjetet monetare në fund të periudhës	12	**109,043**	**148,599**

Shënimet shpjeguese në faqet 7-42 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura.

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

PASQYRA E NDËRMJETME E PËRMBLEDHUR E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA
Për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022
(000/Lekë)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Rezerva rivlerësimi	Rezerva ligjore	Fitim/humbje të akumuluara	Totali
1 janar 2021	**18,250,000**	**23,153**	**2,686,506**	**232,302**	**(14,823,675)**	**6,368,286**
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(427,920)	**(427,920)**
Transferim në fitime/(humbje) të mbartura	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithperfshirese nga tatimi I shtyre	-	-	-	-	(1,054)	**(1,054)**
30 qershor 2021	**18,250,000**	**23,153**	**2,686,506**	**232,302**	**(15,252,649)**	**5,939,312**
1 janar 2022	**18,250,000**	**23,153**	**2,550,980**	**232,302**	**(15,347,004)**	**5,709,431**
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	-	-	(82,438)	**(82,438)**
Te ardhura te tjera gjithperfshirese tatim i shtyre	-	-	-	-	27,514	**27,514**
30 qershor 2022	**18,250,000**	**23,153**	**2,550,980**	**232,302**	**(15,401,928)**	**5,654,507**

Shënimet shpjeguese në faqet 7-42 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të ndërmjetme të përmbledhura.

Pasqyrat Financiare të ndërmjetme të përmbledhura 30 qershor 2022, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë _____ dhe u firmosën në emër të tij nga:

Ervin Shpori

Drejtor i Përgjithshëm

J61824053N TIRANA-ALBANIA ALBtelecom

Myrvete FERHATI

Dr/ Drejtorisë Kontabilitetit dhe Taksave

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

"ALBTELECOM" SH.A. është regjistruar si shoqëri aksionere me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, numër 20820 datë 18.02.1999, të Regjistrit Tregtar, në përputhje me ligjin Nr 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Kapitali i shoqërisë është 18,250,000 mijë lekë.

Shoqëria ofron një gamë të gjerë shërbimesh të telefonisë fikse (1Play, 2Play, 3Play, 4Play), shërbimet e telefonisë mobile (prepaid dhe postpaid, internet, data), shërbimet e shitjes me shumicë si: interkoneksionit kombëtar dhe ndërkombëtar, tranzitimit, shërbimet e roaming, data lease line, shërbim interneti, dhënia me qira e objekteve etj.

Organi drejtues i Shoqërisë është këshilli administrativ.

Anëtarë bordi deri më 04.03.2025:

Emri	Funksioni	Vendodhja
Aladin Ádám Linczényi	Kryetar	Hungari
Péter Krisztián Fekete	Anëtar	Hungari
Laszlo Blenessy	Anëtar	Hungari
Csaba Ferenc Thurzó	Anëtar	Hungari
Irida Peci	Anëtar	Shqipëri

Selia e shoqërisë është Rruga "Muhedin Llagami", Sheshi 21, Tiranë.
Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me Licensë Nr. 3898113 dhe NIPT J61824053N.

Kompania synon të hyjë në procesin e bashkimit me ONE Communication Albania që do të ndikojë pozitivisht në pjesën e tregut dhe cilësinë e shërbimit fiks dhe celular për abonentët e të dy subjekteve. Në shtator 2022 do të nisë procesi i shitjes së kryqëzuar të produkteve të të dy subjekteve si dhe unifikimi i portofolit të tyre të produkteve.
Procesi ligjor i bashkimit që pritet të ndodhë në vitin e ardhshëm nuk ka filluar ende.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura për periudhën 6 mujore të përfunduar më 30 qershor 2022 janë përgatitur në përputhje me Standardin e Kontabilitetit SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm.
Ky raport i ndërmjetëm nuk përfshin të gjitha shënimet e tipit të përfshirë normalisht në një raport financiar vjetor. Rrjedhimisht, ky raport do të lexohet në lidhje me raportin vjetor për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe çdo njoftim publik të bërë nga Albtelecom sh.a. gjatë periudhës së ndërmjetme të raportimit.

2.2 Baza e matjeve

Pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA (VAZHDIM)

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më te afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.
Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore.

Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME TË PËRMBLEDHURA (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.2. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

2.5.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktivit financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore.

Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

2.5.4. Provizione

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund te mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Nga njoftimet kontabël e shpallura, për standarded që hyjnë në fuqi nga 1 janari 2022, nuk ka pasur ndryshime që të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të përmbledhura të ndërmjetme të njësisë ekonomike.
Standarde dhe ndryshime të tjera që janë efektive për herë të parë në 2022 dhe mund të zbatohen për njësinë ekonomike janë:

- Referenca në Kuadrin konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)
- Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid 19 përtej datës 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF16)
- Aktivet afatgjata materiale, impiantet dhe pajisjet: të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- • Kontratat e rënda - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- • Përmirësimi vjetor (cikli 2018-2020)
- • Filial si adoptues për herë të parë (Ndryshimet në SNRF 1)
- • Tarifat në testin '10 përqind' për mosnjohjen e pasiveve financiare (Ndryshimet në SNRF 9)
- Stimujt e qirasë (Ndryshimet në SNRF 16)
- Tatimi në matjet e vlerës së drejtë (Ndryshimet në SNK 41).

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare të Ndërmjetme dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur

3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka publikuar një sërë standardesh dhe interpretimesh që janë efektive në periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur të mos i zbatojë paraprakisht. Kompania planifikon të zbatojë këto standarde dhe interpretime kur ato të hyjnë në fuqi.
Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar, por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të përfunduar më 30 qershor 2022:

- Paraqitja e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që lindin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

4.1. Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqiperisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në Lek):

Monedha	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
1 EUR	119.13	120.76
1 USD	114.22	106.54
1 GBP	138.56	143.95
1 SDR	152.24	149.11

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.4 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2. Instrumentat Financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e flukseve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2. Instrumentat Financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare – **pakësimi i vlerës.** Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.2. Instrumentat Financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3 Përcaktimi I vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak te maturimit të tyre afatshkurtër.

4.4 Inventari

Inventarët që përfshijnë kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesorët përkatës dhe kancelari e paisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.5 Aktivet Afatgjata Materiale

Zërat e llogarisë toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje të telekomunikacionit janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kosto historike përfshin çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit, dhe taksa të pakthyeshme në blerje, pasi pakësohet nga zbritjet tregtare, çdo kosto tjetër për të sjellë aktivin në vendodhjen dhe kushtet e nevojshme në mënyrë që të jetë i gatshëm për përdorim në mënyrën e parashikuar nga manaxhimi i shoqërisë, si dhe kostot për çmontimin e asetit në rast se është e nevojshme.

Çdo interes i lidhur me një aktiv afatgjatë material në ndërtim, kapitalizohet në momentin kur fillon ndërtimi i aktivit dhe pushon së kapitalizuari në momentin kur aktivi përfundon së ndërtuari.

Kosto historike e pajisjeve të telekomunikacionit përfshin të gjitha shpenzimet përfshirë dhe shtrirjen e rrjetit në ambjentet e konsumatorëve. Kosto përfshin punën e gjeneruar së brendshmi për një zë specifik të aktiveve afatgjata materiale.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Kostot e mëpasshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të asetit, ose njihen si aset më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin ne fjalë, do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e një pjese që zëvendësohet çrregjistrohet. Të gjitha kostot e mirëmbajteve dhe riparimeve i ngarkohen periudhës financiare në të cilën kane ndodhur.

Ndërtimi në proçes përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjata materiale ende të papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende të papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ ose paraardhëse financiare. Pas përfundimit, këto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proçes, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjata materiale.

Për të përcaktur nëse një aktiv që ka në përbërjen e tij si elemente materialë ashtu dhe jomaterialë, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet.

Amortizimi vjetor paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Normat vjetore të amortizimit aplikohen mbi vlerën e mbetur të aktiveve dhe janë si vijon:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2022	2021
Ndërtesa	3%	3%
Instalime Teknike (Linja)	3%	3%
Makineri e pajisje	15%	15%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje orendi	20%	20%
Pajisje elektronike	25%	25%

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

Shoqëria për efekte fiskale operon me normat:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2022	2021
Ndërtesa	5%	5%
Instalime Teknike (Linja)	5%	5%
Makineri e paisje	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje orendi	20%	20%
Pajisje elektronike	25%	25%

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.6 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përftuar përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më te hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.6 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.7 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe të drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja
Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme
Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi
Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirese duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatesia e parashikuar e aktiveve për periudhat aktuale dhe krahasuese është 7 vjet.

4.8 Zhvlerësimi i aktiveve fikse (Rënia në vlerë)

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përllogaritet në çdo datë të bilancit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e mbartur e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyre të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo një njësie që gjeneron flukse paraje është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.8 Zhvlerësimi i aktiveve fikse (Rënia në vlerë) (vazhdim)

Humbja nga zhvlerësimi anullohet nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe nëse kanë ndryshuar supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar pasi të ishte zbritur zhvlerësimi dhe amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

4.9 Aktive investuese

Aktivi investues është aktiv i mbajtur për t'u dhënë me qira dhe/ose rivlerësim i kapitalit (përfshirë aktivet në ndërtim për qëllime të tilla), fillimisht maten me kosto, përfshirë kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen në Shoqëri pavarësisht nëse titulli është transferuar apo jo. Fillimisht maten me kosto. Pas periudhës së njohjes, aktivet e investimit maten me modelin e kostos. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve të investimit llogaritet bazuar në vlerën e tyre të mbetur. Aktivet e investimeve të mbajtura nga një qiramarrës si një aktiv i përdorimit të drejtë maten fillimisht me koston në përputhje me SNRF 16.

4.10 Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur duke pakësuar shpenzimet e amortizimit të periudhes në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjate jetës së dobishme të aktivit.

4.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë të rëndësishme.

4.12 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fitime te gjeneruara gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqerisë. Te ardhurat njihen per shumen e çmimit te transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.
Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

4.PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhurat nga shërbimet

Shoqeria ofron shërbime me kontrata me çmim fiks dhe me çmime të ndryshueshme. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen. Për kontratat me çmim fiks, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit aktual të ofruar deri në fund të periudhës raportuese si një pjesë e totalit të shërbimeve që duhet të ofrohen, sepse klienti merr dhe përdor përfitimet njëkohësisht.

Kur kontratat përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit.

Matja e të ardhurave, kostove ose fazes së progresit drejt përfundimit rishikohen nëse rrethanat ndryshojnë. Çdo rritje ose zvogëlim i të ardhurave ose shpenzimeve të llogaritura reflektohet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën rrethanat që sjellin rishikimin bëhen të njohura nga drejtimi.
Në rastin e kontratave me çmim fiks, klienti paguan shumën fikse bazuar në një skemë pagesash. Nëse shërbimet e kryera nga Shoqeria e tejkalojnë pagesën, njihet një aktiv i kontratës. Nëse pagesat tejkalojnë shërbimet e kryera, njihet një detyrim kontrate.

Nëse kontrata përfshin shuma te ndryshueshme, të ardhurat njihen vetëm në masën që ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë lidhur me shumën e ndryshueshme nuk do të sjellë anullim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluara të njohura.

Shoqeria nuk pret që të ketë ndonjë kontratë ku periudha ndërmjet transferimit të mallrave ose shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti kalon një vit. Si pasojë, Shoqeria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën kohore të parasë.

Të ardhurat nga shërbimet konsistojnë në:

- tarifat e abonimit,
- tarifat e shërbimit telefonik,
- pajtimi mujor dhe shërbime të tjera,
- tarifat roaming,
- shërbimet e interkonjeksionit.

Të ardhurat nga këto shërbime njihen si më poshtë:

Tarifat e abonimit

Të ardhurat e lidhura me tarifat mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (Vazhdim)

Shërbimi telefonik, pajtimi mujor dhe tarifa të tjera

Shërbimi telefonik bazohet në trafikun e krijuar nga koha e bisedes se kryer nga abonenti, tarifa e aplikuar, destinacioni i thirrjes dhe lloji i shërbimit. Tarifat e shërbimit telefonik varen nga trafiku, koha e bisedës së përdorur apo volumi i të dhënave të transmetuara për shërbimet me vlerë të shtuar, përdorimi i internetit dhe shërbimet e të dhënave. Të ardhurat nga sherbimi telefonik dhe shërbimet me vlerë të shtuar njihen në periudhën kur shërbimet ofrohen. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimit që daton në fund të çdo muaji, përllogariten në bazë të trafikut dhe regjistrohen në fund te muajit.

Kur kontratat përfshijnë dhënien e mallrave falas/me çmim te reduktuar, vouchera, ose shërbime shtese, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit. Te ardhurat nga shërbimi njihen vetëm per pjesën relative te çmimit te transaksionit.

Shitja e Kartave të parapaguara

Të ardhurat nga shitja e kartave rimbushëse me parapagesë dhe kohës së bisedës për shërbimin me parapagesë, neto nga uljet e lejuara, të përfshira në paketat e shërbimit me parapagesë të Shoqërisë, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tarifat Roaming

Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në të njëjtën mënyrë edhe operatorët faturojnë Shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur shërbimet janë ofruar.

Tarifat e Interkonjeksionit

Të gjitha thirrjet që kanë një numër Albtelecom si numër terminimi dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër origjinues, krijojnë një marrëdhënie të ardhurash midis ALBTELECOM-it dhe shoqërisë tjetër. Këto të ardhura njihen si të ardhura interkonjeksioni mes dy shoqërive.
Të ardhurat e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet që terminojne në rrjetin e ALBTELECOM-it nga rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular.

Të gjitha thirrjet që kanë një numër ALBTELECOM si numër origjinues dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër terminues, krijojnë një marrëdhënie kostoje midis shoqërisë tjetër dhe ALBTELECOM-it. Kjo kosto njihet si kosto interkonjeksioni mes dy shoqërive. Kostot e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet e origjinuara në rrjetin e ALBTELECOM-it dhe të terminuara në rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular, duke përdorur rrjetet e shoqerive.

Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën kur thirrja merret/pranohet në rrjetin e Shoqërise (dhe në rrjetin e operatorit tjeter përkatësisht)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.12 Njohja e të ardhurave (Vazhdim)

Të ardhurat nga shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave ose dhenia e tyre falas/me cmim te reduktuar njihen kur kontrolli i mallit është transferuar, pra kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, klienti ka te drejta te plota mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave të klientit. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendodhjen specifike, rreziqet e humbjes janë transferuar tek klienti dhe klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën ose Shoqeria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.
Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, neto nga uljet. Përvoja e akumuluar përdoret për të vlerësuar sigurine mbi zbritjet, duke përdorur metodën e vlerës së pritshme dhe të ardhurat njihen vetëm në masën që është shumë e mundshme që një ndryshim i rëndësishëm nuk do të ndodhë.
Detyrimi i Shoqerise për të riparuar ose zëvendësuar mallrat sipas kushteve standarde të garancisë njihet si një provizion.

Kur kontratat përfshijnë dhënien e mallrave falas/me çmim te reduktuar, vouchera, ose shërbime shtese, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet specifike te shitjes. Kur këto çmime specifike nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin e fitimit. Te ardhurat nga mallrat e dhena falas ose me çmim të reduktuar dhe nga voucherat njihen vetëm per pjesën relative te çmimit te transaksionit.

Të ardhurat nga shitja e aksesorëve, neto nga uljet e lejuara, njihen në momentin e dorëzimit të mallrave kur e drejta e pronësisë dhe rreziku i humbjes i kalojnë klientit.

Të ardhurat nga qiraja - Linjat e dhëna me qira

Shoqëria jep me qira linja kryesisht operatorëve mobile në mënyre që rrjeti i tyre të lidhet me rrjetin fiks të Albtelekom Sh.a. Të ardhurat fikse të qirase për këto linja njihen në bazë të metodës lineare mbi kushtet kontraktuale të qirasë. Të ardhurat nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës lineare sipas kohezgjatjes së qirasë.

Të ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshëm mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përllogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

4.13 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.
Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.14 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shendetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.15 Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.16 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishem në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Toka Ndërtesa	Linja dhe paisje të telekomunikacionit	Makineri e paisje	Mjete Transporti	Paisje zyre e informatike	Aktive në proces	Totali
Kosto							
Gjendja më 01 janar 2021	6,451,279	13,553,474	4,523,575	166,110	3,495,398	315,406	28,505,242
Shtesa	-	-	96,163	-	177,528	412,638	686,329
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(1,734)	-	(1,734)
Pakesime	-	-	(2,504)	(5,834)	(21,801)	-	(30,139)
Rivlersime	-	(1,631,347)	-	-	-	-	(1,631,347)
Transferime	41,554	121,685	178,840	-	139,124	(481,788)	(585)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	6,492,833	12,043,812	4,796,074	160,276	3,788,515	246,256	27,527,766
Shtesa	-	-	45,222	-	71,333	187,650	304,205
Nxjerrje jashtë përdorimit	(82)	-	(62)	(1,768)	(10,604)	-	(12,516)
Pakesime	-	-	-	-	(692)	-	(692)
Transferime	5,907	192,899	56,992	-	15,448	(275,776)	(4,530)
Gjendja më 30 qershor 2022	6,498,658	12,236,711	4,898,226	158,508	3,864,000	158,130	27,814,233
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 31 janar 2021	2,196,092	1,495,825	867,502	129,783	2,493,337	-	7,182,539
Amortizimi i vitit	127,990	359,788	558,565	7,203	265,055		1,318,601
Rivlerësime	-	(1,495,822)	-	-	-		(1,495,822)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(8,752)		(8,752)
Pakesime	-	-	(535)	(5,467)	(1,442)		(7,444)
Gjendja më 30 qershor 2022	2,324,082	359,791	1,425,532	131,519	2,748,198	-	6,989,122
Amortizimi i vitit	62,578	177,142	251,336	2,832	116,586		610,474
Nxjerrje jashtë përdorimit	(34)		(18)	(936)	(4,960)		(5,948)
Pakesime					(660)		(660)
Gjendja më 30 qershor 2022	2,386,626	536,933	1,676,850	133,415	2,859,164	-	7,592,988
Zhvlerësimi i AAM-ve							
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	-	504	361	9,526	2,502	12,893
Gjendja më 30 qershor 2022	-	-	504	361	9,526	2,502	12,893
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,168,751	11,684,021	3,370,038	28,396	1,030,791	243,754	20,525,751
Gjendja më 30 qershor 2022	4,112,032	11,699,778	3,220,872	24,732	995,310	155,628	20,208,352

5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Shoqëria vlerëson aktivet e saj me vlerën e drejtë siç përshkruhet në shënimin 4.5 të këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria ka kryer rivlerësimin e pare të aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2008.

Më 1 janar 2020 shoqëria ka kryer rivlerësimin e kryer rivlerësimin e grupit të "Makineri dhe paisje" Ndërsa më 1 janar 2021, shoqëria ka kryer rivlerësimin me vlerën e drejtë grupit të "Linjave dhe paisje te telekomunikacionit", bazuar në vlerësimin e bërë nga ekspertë vlerësues.
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkojnë kryerjen e rivlerësimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale periodikisht çdo 3 ose 5 vjet në rast se ekzistojnë tregues që vlera e drejtë e këtyre aktiveve ka ndryshime të rëndësishme nga vlera e mbartur e tyre.

Manaxhimi ka gjykuar se nuk ekzistojnë tregues që vlera e drejtë e aktiveve afatgjata materiale ka ndryshime të rëndësishme për grupin e makineri paisjeve , për shkak të futjes së teknologjisë së re dhe zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale, si dhe të kompatibilitetit të teknologjisë së futur rishtazi me atë ekzistuese.

6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për periudhën e mbyllur më 30 qershor 2022 janë si më poshtë:

	Licenca dhe te tjera	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2021	3,998,894	3,998,894
Shtesa	6,298	6,298
Transferime	586	586
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,005,778	4,005,778
Shtesa	4,125	4,125
Gjendja më 30 qershor 2022	4,009,903	4,009,903
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2021	1,810,224	1,810,224
Amortizimi i vitit	218,895	218,895
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,029,119	2,029,119
Amortizimi i vitit	103,317	103,317
Gjendja më 30 qershor 2022	2,132,436	2,132,436
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	1,976,659	1,976,659
Gjendja neto më 30 qershor 2022	1,877,467	1,877,467

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

7. AKTIVET NË PËRDORIM

Lëvizjet e aktiveve në përdorim për periudhën e mbyllur më 30 qershor 2022 janë si më poshtë:

	Buildings	Sites	Dark fiber	TOTAL
Gjendja më 1 janar 2021	1,967,396	926,560	30,642	2,924,598
Shtesa	636,995	62,516	3,306	702,817
Transferime	204,449	-	-	204,449
Nxjerrje jashtë përdorimit	(348,058)	-	-	(348,058)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**2,460,782**	**989,076**	**33,948**	**3,483,806**
Shtesa	23,757	89,773	-	113,530
Nxjerrje jashtë përdorimit	(1,470,001)	(5,283)	-	(1,475,284)
Gjendja më 30 qershor 2022	**1,014,538**	**1,073,566**	**33,948**	**2,122,052**
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2021	172,157	355,929	12,877	540,963
Shtesa	148,194	184,018	7,105	339,317
Transferime	69,420	-	-	69,420
Nxjerrje jashtë përdorimit	(79,048)	(3,786)	-	(82,834)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**310,723**	**536,161**	**19,982**	**866,866**
Shtesa	80,331	88,486	3,579	172,396
Nxjerrje jashtë përdorimit	(7,860)	(4,395)	-	(12,255)
Gjendja më 30 qershor 2022	**383,194**	**620,252**	**23,561**	**1,027,007**
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**2,150,059**	**452,915**	**13,966**	**2,616,940**
Gjendja më 30 qershor 2022	**631,344**	**453,314**	**10,387**	**1,095,045**

8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA

Në zërin "Kredi të dhëna" pasqyrohet kredia e dhënë punonjësve për banesa e cila vazhdon të shlyhet mbi bazën e kontratave 20 -25 vjeçare duke filluar nga vitit 1997.

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Kredi të dhëna personelit	18,380	19,467
	18,380	**19,467**

9. INVENTARI

Gjendjet e inventarit janë të analizuara si vijon:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Materiale të para	329,422	336,639
Produkte e mallra	380,733	364,287
Të tjera gjendje inventari	14,109	18,289
Zhvlerësimi për inventare	(392,720)	(405,324)
	331,544	**313,891**

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit janë të analizuara si vijon:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja 1 janar	405,324	324,491
Shtesa provizione	(12,604)	80,833
Gjendja	**392,720**	**405,324**

10. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATSHKURTRA

10.1 Analiza e llogarive të arkëtueshme

Në përgjithësi, llogaritë e arkëtueshme dhe zhvlerësimi i tyre është i detajuar si më poshtë.

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Klientë për shitje e shërbime	3,107,437	3,112,121
Zhvlerësimi i kërkesave për arkëtim	(2,329,977)	(2,270,101)
Neto llogari të arkëtueshme tregtare	**777,460**	**842,020**
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	263,476	267,933
Zhvlerësimi i të tjerave të arkëtueshme	(185,382)	(194,023)
Neto llogari të tjera të arkëtueshme	**78,094**	**73,910**
Totali	**855,554**	**915,930**

10. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA (VAZHDIM)

10.2 Llogaritë e arkëtueshme ndaj klientëve

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Klientë për trafikun kombëtar		
Abonentë Familjarë	867,406	833,841
Abonentët biznes	1,117,571	1,127,763
Minus Zhvlerësimi	(1,491,347)	(1,457,469)
Klientë për trafikun ndërkombëtar	440,829	480,343
Minus Zhvlerësimi	(360,094)	(335,876)
Operatorë Internet dhe qira linjash	444,552	464,006
Distrubutorët e Kartave	168,694	169,120
Klientë të tjerë	68,385	37,048
Minus Zhvlerësimi	(478,536)	(476,756)
	777,460	**842,020**

10.3 Provizionet për zhvlerësim për kërkesat për arkëtim

Gjatë periudhës financiare të ndërmjetme të përmbledhur më 30 qershor 2022 në llogaritë e provizioneve për zhvlerësimin e kërkesave për arkëtim, kanë ndodhur lëvizjet si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja më 1 janar	2,464,124	2,482,255
Shtesa provizione	51,235	38,651
Rimarrje për vitin		(56,782)
Gjendja	**2,515,359**	**2,464,124**

10.4 Të tjera llogari të arkëtueshme

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagim Detyrimi sipas akt kont gjoba dhe interesa	208,392	208,393
Të tjera kerkesa	55,084	59,540
Minus Zhvlerësimi kërkesa të tjera	(185,382)	(194,023)
	78,094	**73,910**

11. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Balanca e parapagimive dhe shpenzimeve të shtyra më 30 Qershor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime për furnitorët	67,928	43,940
Shpenzime të shtyra	137,715	67,357
Shpenzime të shtyra afatshkurtra	*52,682*	*48,022*
Shpenzime të shtyra afatgjata	*85,033*	*19,335*
	205,643	**111,297**

12. MJETET MONETARE NË ARKË E NË BANKË

Mjetet monetare më 30 Qershor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në arkë	27	27
Llogari rrjedhëse	94,089	76,668
Para të bllokuara në llogari		
Para në udhëtim	14,927	75,537
	109,043	**152,232**

Depozitat me afat kanë maturitet më pak se 3 muaj.

Detaje të mëtejshme të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj sipas monedhës:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në bankë	**94,089**	**76,668**
në USD	984	90
në EURO	4,309	10,098
në ALL	88,709	66,442
në GBP	87	37
në TRY	-	1
Mjete monetare në arkë	**27**	**27**
në EURO	-	-
në ALL	27	27
Para në udhëtim	14,927	75,537
	109,043	**152,232**

13. KAPITALI AKSIONAR

Struktura dhe shuma e kapitalit është si më poshtë :

	2022			2021		
	%	Nr. Aksioneve	Kapitali i nënshkruar	%	Nr. Aksioneve	Kapitali i nënshkruar
METE	13.78%	2,515,255	2,515,255	13.78%	2,515,255	2,515,255
Posta Shqiptare	2.47%	450,000	450,000	2.47%	450,000	450,000
Aksionerët e tjerë (individë)	3.48%	634,745	634,745	3.48%	634,745	634,745
CETEL	-	-	-	80.27%	14,650,000	14,650,000
4iG	80.27%	14,650,000	14,650,000	-	-	-
Total	**100.00%**	**18,250,000**	**18,250,000**	**100.00%**	**18,250,000**	**18,250,000**

Më 8 dhjetor 2021, CETEL TELEKOM, në cilësinë e shitësit dhe 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG, një kompani e themeluar sipas ligjeve të Hungarisë ("4IG" ose "Blerësi"), në cilësinë e blerësit, nënshkroi një kontratë për shitjen e aksione nëpërmjet të cilave CETEL TELEKOM i shet 4IG aksionet e saj në Albtelecom, të cilat përbëjnë 80.27% të të gjithë kapitalit aksioner të Shoqërisë.

Kjo kontratë ishte një kontratë e kushtëzuar, e cila parashikonte zbatimin e disa parakushteve për të bërë efektive kalimin e 80.27% të aksioneve të shoqërisë nga CETEL TELEKOM tek aksioneri i ri 4iG. Afati për plotësimin e kushteve paraprake ishte parashikuar të jetë 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Si pjesë e parakushteve është marrë një autorizim nga organet rregullatore, si AKEP, AMA dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Në datën 04.03.2022, kur u plotësuan të gjitha parakushtet, në përputhje me përcaktimet e kontratës së datës 08.12.21, palët vazhduan me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare të transferimit të aksioneve nga CETEL TELEKOM te blerësi ("Marrëveshja e Transferimit") .

14. HUATË

Huatë për periudhën e mbyllur më 30 qershor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 paraqiten të detajuara poshtë:

Balanca për periudhën e mbyllur më 30 qershor 2022:

	Monedha	Principali i mbetur i Huasë në monedhë	Interesi në %	Shuma Ekuivalente Në 000/Leke	Shuma Deri në 1 Vit	Shuma mbi 1 Vit
4iG	EUR	76,371	6.00%	9,098,023	-	9,098,023
Calik Holding	EUR	675	5.35%	80,400	80,400	-
BKT 1	ALL	3,958,310	4.00%	3,958,310	338,000	3,620,310
Italian Government	EUR	1,135	1.00%	135,188	45,063	90,125
Tirana Bank Overdraft 1	EUR	241	4.75%	28,736	28,736	-
Tirana Bank Overdraft 2	ALL	334,921	5.50%	334,921	334,921	-
Raiffeisen Bank Overdraft 1	EUR	1,000	5.30%	119,130	119,130	-
Raiffeisen Bank Overdraft 2	EUR	500	5.50%	59,565	59,565	-
Raiffeisen Bank Overdraft 3	EUR	150	5.30%	17,870	17,870	-
Raiffeisen Bank Loan 1	EUR	333	5.30%	39,695	29,767	9,928
Raiffeisen Bank Loan 2	EUR	400	5.30%	47,651	23,826	23,825
Raiffeisen Leasing	EUR	9.75	E12M+4%, not less than 4%	1,104	1,104	-
Interesa Maturuara	ALL			183,945	183,945	-
Totali 30 Qershor 2022				**14,104,538**	**1,262,327**	**12,842,211**

14. HUATË (VAZHDIM)

Balanca për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2021:

	Monedha	Principali i mbetur i Huasë në monedhë	Interesi në %	Shuma Ekuivalente Në 000/Leke	Shuma Deri në 1 Vit	Shuma mbi 1 Vit
Aktif Bank	EUR	43,206	5.00%	5,217,599	-	5,217,599
Calik Holding	EUR	30,252	5.48%	3,653,259	-	3,653,259
BKT 1	ALL	2,787,969	4.00%	2,787,969	174,000	2,613,969
BKT 2	ALL	783,219	4.00%	783,219	48,000	735,219
BKT 3	ALL	267,415	4.00%	267,415	28,703	238,712
BKT 4	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 5	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	-
BKT 6	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 7	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	-
BKT 8	ALL	58,000	4.00%	58,000	58,000	-
BKT 9	ALL	16,000	4.00%	16,000	16,000	-
Italian Government	EUR	1,324	1.00%	159,877	45,679	114,198
Tirana Bank Overdraft 1	EUR	341	4.75%	41,205	41,205	-
Tirana Bank Overdraft 2	ALL	396,447	5.50%	396,447	396,447	-
Raiffeisen Bank Overdraft 1	EUR	1,000	5.30%	120,760	120,760	-
Raiffeisen Bank Overdraft 2	EUR	500	5.50%	60,380	60,380	-
Raiffeisen Bank Overdraft 3	EUR	150	5.30%	18,114	18,114	-
Raiffeisen Bank Loan 1	EUR	458	5.30%	55,348	30,190	25,158
Raiffeisen Bank Loan 2	EUR	500	5.30%	60,380	24,152	36,228
Raiffeisen Leasing	EUR	23	E12M+4%, not less than 4%	2,777	2,777	
Interesa Maturuara	ALL			422,828	422,828	
Total 31 dhjetor 2021				**14,269,577**	**1,635,235**	**12,634,342**

15. QIRAJA FINANCIARE

Lëvizjet e qirave financiare paraqiten si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	527,977	471,344
Detyrimet afatgjatë të qirasë	870,000	2,467,007
	1,397,977	**2,938,351**

Shuma të njohura në të ardhura e shpenzime

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Shpenzime amortizimi te aktiveve me te drejta ne perdorim	172,396	339,316
Shpenzimet e interesit (të përfshira në koston e financimit)	47,243	143,739
Shpenzimet që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët	624	1,794
Shpenzimi në lidhje me pagesat e qirasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qirasë	9,630	24,375
	229,893	**509,224**

16. PROVIZIONET

Lëvizjet e provizioneve për rreziqe paraqiten si vijon:

Proviozione afatgjatë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja më 1 janar	98,200	98,200
Shtesa provizione	-	-
	98,200	**98,200**

Proviozione afatshkurtër:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Gjendja më 1 janar	49,383	49,383
Shtesa provizione	38,778	-
Rimarrje për vitin	(6,612)	-
	81,549	**49,383**

17. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare ndahen në afatshkurtra dhe afatgjata si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari të pagueshme tregtare afatgjata	-	-
Llogari të pagueshme tregtare afatshkurtra	1,775,632	2,190,359
	1,775,632	**2,190,359**

Llogaritë e pagueshme detajohen më tej:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
MAKHES ALBANIA	258,144	271,333
CALIK HOLDING A.S	186,484	195,177
GOGEL shpk	175,078	185,158
OKTAPUS shpk	174,489	216,964
Bayerische Landesbank	77,470	130,884
DIGIT ALB sha	72,918	83,320
Telekom Slovenije d.d.	70,977	71,930
TRING TV SH.A.	55,795	55,504
	26,679	51,573
	13,415	253,318
Furnitore te tjere	664,183	675,198
	1,775,632	**2,190,359**

18. GRANTET, TË ARDHURAT E SHTYRA DHE DETYRIME TË TJERA

Grantet përfaqësojnë pajisje telekomunikacioni ndërsa të ardhurat e shtyra për kohë të pakonsumuar përfaqësojnë kohë bisede të pakonsumuar të kartave rimbushëse të shitura në fund të vitit.

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Grante	51,638	57,623
Të ardhura të shtyra për kohë të pakonsumuar	54,957	69,874
Të ardhura të shtyra nga kontrata me klientet	225,344	239,133
	331,939	**366,630**

19. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Detyrimet të tjera afatshkurtra të shoqërisë janë të analizuara si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Personeli	61,092	129
Sigurime shoqërore	16,853	17,162
Shteti tatime e taksa	54,209	68,607
Të tjera detyrime	244,647	30,751
	376,801	**116,649**

Detyrimet ndaj punonjësve

Marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë me punonjësit e tyre bazohen në kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata kolektive e punës është lidhur ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj për përcaktimin e detyrimeve reciproke që lindin nga marrëdhënia e punës.
Sipas legjislacionit të punës në fuqi, shoqëria mund të penalizohet deri në 15 paga mujore në rast të një ndërpreje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të marrëdhënies së punës me punonjësin e saj.
Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë provizion lidhur me kostot e mundshme nga ndërprerja e menjëhershme dhe e pa justifikuar e kontratave të punës me punonjësit e saj.

Numri mesatar i personelit sipas funksioneve është si vijon:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Drejtorë, Manaxherë e drejtues departementi	99	101
Specialistë	547	595
Personel teknik	38	37
Punëtorë	15	3
Stafi ndihmës	4	17
	703	**753**

Shteti tatim e taksa

Shteti tatim e taksa analizohet si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
TVSH për t'u paguar	43,093	46,845
Tatim mbi të ardhurat personale	8,044	8,755
Tatimi në burim	3,072	13,007
	54,209	**68,607**

20. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Shërbimi telefonik kombëtar fix	1,048,831	1,214,160
Shërbimi telefonik kombëtar mobile	1,074,990	973,569
Shërb. telefonik ndërkombetar	256,000	251,429
Shërbimi Roaming	42,478	24,691
Shërbimi interkoneksionit ndaj operatorëve	317,935	357,654
Internet, ADSL, ISDN, LAN,internet IP	396,758	357,545
Shërbimet e instalimit	12,477	11,660
Linjat dhe qarqet me qera	59,056	54,316
Të ardhura të tjera	975	1,410
Shërbimi i kartës së parapaguar	3	33
Total të ardhura nga veprimtaria kryesore	**3,209,503**	**3,246,467**
Nga modem dhe ADSL, Sim Card dhe të tjera	16,719	15,828
Shitje aparati telefonik	283	1,333
Ifrs 15 adjustment	263	(4,301)
Aksesorë	65	56
Total shitje	**17,330**	**12,916**
Te ardhura nga qiraja	39,284	40,078
Te ardhura nga sherbime per fix	1,654	1,068
Te tjera	13,308	5,824
Te ardhura te tjera	**54,246**	**46,970**
Total shitje neto	**3,281,079**	**3,306,353**

21. SHPENZIMET

Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e ndara sipas natyrës dhe funksionit për vitin e mbyllur më 30 qershor 2022 dhe 30 qershor 2021.

	30 qershor 2022			
	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile AMC	101,054	-	-	101,054
Operatorët Mobile Vodafon	139,835	-	-	139,835
Operatorët Rurale/alternativë	2,450	-	-	2,450
Operatorë të tjerë (vas)	84	-	-	84
Operatorët Ndërkombëtarë	260,090	-	-	260,090
Shpenzime Interneti	91,079	-	-	91,079
Licensa	82,900	-	-	82,900
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	1,697	1,660	3,357
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	292,188	3,403	35,766	331,357
Shpenzime Qeraje	808	7,776	2,413	10,997
Shpenzime Qeraje nga aplikimi I IFRS 16	-	-	-	-
Rojet e Objekteve	-	-	12,565	12,565
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	2,840	-	6,855	9,695
Reklamë e Publicitet	-	78,589	-	78,589
Marredhenie me Publikun	-	3,720	-	3,720
Udhëtime e Dieta	-	-	5,238	5,238
Ujë dhe Energji elektrike	137,313	-	15,679	152,992
Komisionet Bankare	-	-	1,443	1,443
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	193,270	66,625	51,318	311,213
Shpenzime për Materiale	16,410	1,238	21,859	39,507
Shpenzime për Mallra	3,685	745	69	4,499
Tatime e taksa	-	-	13,494	13,494
Pagat	192,671	175,283	177,509	545,463
Trajtime dhe shpërblime të tjera	2,443	-	8,594	11,037
Amortizimi	680,256	113,731	86,253	880,240
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	-	-	59,877	59,877
Zhvleresim I inventarit	-	-	(12,604)	(12,604)
Shpenzime borxh i keq	-	-	1,152	1,152
Provizion per leje	-	-	32,166	32,166
Shpenzime të tjera rrjedhëse	5,245	1,004	8,925	15,174
Totali	**2,204,621**	**453,811**	**530,231**	**3,188,663**

21. SHPENZIMET (VAZHDIM)

	30 qershor 2021			
	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	Totali
Operatorët Mobile AMC	111,773	-	-	111,773
Operatorët Mobile Vodafon	171,212	-	-	171,212
Operatorët Rurale/alternativë	5,641	-	-	5,641
Operatorë të tjerë (vas)	131	-	-	131
Operatorët Ndërkombëtarë	202,909	-	-	202,909
Shpenzime Interneti	119,276	-	-	119,276
Licensa	92,115	-	-	92,115
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	5,930	6,515	12,445
Shpenzimet e Mirëmbajtjes	338,352	3,190	37,698	379,240
Shpenzime Qeraje	1,559	7,322	5,702	14,583
Shpenzime Qeraje nga aplikimi I IFRS 16	-	-	-	-
Rojet e Objekteve	-	-	16,069	16,069
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	2,713	-	8,200	10,913
Reklamë e Publicitet	-	117,738	-	117,738
Marredhenie me Publikun	-	4,039	-	4,039
Udhëtime e Dieta	-	-	4,959	4,959
Ujë dhe Energji elektrike	121,058	-	17,286	138,344
Komisionet Bankare	-	-	1,315	1,315
Shërbime të ndryshme nga të 3-të	239,822	73,745	61,852	375,419
Shpenzime për Materiale	20,769	1,650	17,783	40,202
Shpenzime për Mallra	8,224	643	13	8,880
Tatime e taksa	-	-	14,591	14,591
Pagat	190,020	177,111	243,746	610,877
Trajtime dhe shpërblime të tjera	1,434	-	-	1,434
Amortizimi	719,276	103,798	93,051	916,125
Shpenzime borxh i keq	-	-	2,860	2,860
Shpenzime të tjera rrjedhëse	2,357	1,028	40,622	44,007
Totali	**2,348,641**	**496,194**	**572,262**	**3,417,097**

22. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit detajohen si më poshtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Rezultati nga dalja jashtë përdorimit dhe shitja e AAM-ve	(70)	608
Të ardhura të tjera	92,113	5,780
Totali	**92,043**	**6,388**

Dalja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	19	623
Shpenzime nga shitja e AAM-ve	(89)	(15)
Rezultati Neto nga shitja e AAM-ve	**(70)**	**608**

23. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare neto janë të detajuara si më poshtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Të ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime për interesa	(403,065)	(440,021)
Shpenzime/ te ardhura per interesa	**(403,065)**	**(440,021)**
Të ardhura/humbje nga këmbimet valutore	358,271	43,589
Humbje nga këmbimet valutore	(203,385)	75,863
Te ardhura/shpenzime financiare neto	(4,915)	(2,995)
Shpenzimet Financiare	**149,971**	**116,457**
Rezultati Financiar	**(253,094)**	**(323,564)**

24. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi i shtyrë i llogaritur për vitin 2022 ka të bëjë me sa vijon:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Fitimi para tatimit	(68,635)	(427,920)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	160,657	
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	92,022	(427,920)
Humbje e mbartur	-	
Tatim fitimi @15%	(13,803)	
Fitimi /(Humbja) e vitit	(82,438)	(427,920)

Lëvizjet e tatim fitimit janë si më poshtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Gjendja 1 Janar	80,821	57,130
Tatim fitim i parapaguar	-	23,691
Tatim fitim i periudhës	(13,803)	-
	67,018	80,821

Tatimi i shtyrë I llogaritur për 2022 paraqitet më poshte:

	30 qershor 2022:	31 dhjetor 2021
Gjendja 1 Janar	974,408	990,958
Efekti mbi fitimin ose humbjen dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në normën tatimore të vitit aktual	(27,505)	(16,550)
	946,903	974,408

24. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Fitimi përpara interesave, taksave, dhe amortizimit i axhustuar

Bordi i Drejtorëve të Kompanisë përdor kryesisht një masë të fitimeve të rregulluara para interesit, tatimit dhe amortizimit (EBITDA, shih më poshtë) për të vlerësuar performancën e aktiviteteve të Kompanisë. EBITDA përjashton efektet e zërave të rëndësishëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat mund të kenë ndikim në cilësinë e fitimeve si kostot e ristrukturimit, të ardhurat/shpenzimet e njëhershme dhe zhvlerësimet ku zhvlerësimi është rezultat i një ngjarjeje të izoluar, jo të përsëritur.

EBITDA	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Fitimi para tatimit	(68,635)	(427,920)
Amortizimi i pronave dhe pajisjeve	604,526	637,550
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	172,396	166,917
Amortizimi i aktiveve jomateriale	103,317	111,657
Shpenzime të tjera jo operative	(35,519)	-
Fitimet/(humbjet) tjera, neto	253,094	323,565
EBITDA	**1,029,180**	**811,769**
Ndikimi i qirasë EBITDA	(215,449)	(210,787)
EBITDA pas qirasë	**813,730**	**600,982**

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqëritë nën të njëjtin kontroll, me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.

Vlerat e paraqitura në seksionin a aktiveve me palët e lidhura më 30 qershor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	-	3,333
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	8,897
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	-	4
Punonjësit e Albtelecom	1,200	1,275
Posta Shqiptare	57,615	56,128
ONE TELECOMMUNICATIONS	12,074	-
ONE Crna Gora DOO Podgorica	4,125	-
4iG Albánia Korlátolt Felelősz	-	-
Total llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	**75,015**	**69,638**

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	-	3,542
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	47,180
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	-
Total mjete monetare pranë palëve te lidhura	**-**	**50,723**

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura detajohen si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Çalık Holding A.Ş.	-	257,873
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş.	-	-
Akılcı Bilişim Çözümleri ve Da	-	5,292
CETEL TELEKOM ILETISIM A.S	-	6,751
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	1,099
Posta Shqiptare	-	1,845
ONE Telecomunnications	3,977	-
ONE Crna Gora DOO Podgorica	4,056	-
4iG Albánia Korlátolt Felelőss	-	-
Total llogari të pagueshme me palët e lidhura	**8,033**	**272,859**

Huatë me palët e lidhura detajohen si më poshtë:

	30 qershor 2022	31 dhjetor 2021
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	-	5,284,993
Çalık Holding A.Ş.	-	4,003,187
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	4,064,366
4iG Albánia Korlátolt Felelőss	9,278,466	-
Total Hua ndaj palëve të lidhura	**9,278,466**	**13,352,546**

Shitjet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 30 qershor 2022 dhe 30 qershor 2021 detajohen si mëposhtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	67,160
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	764
Posta Shqiptare	7,433	7,434
ONE TELECOMMUNICATIONS	73,615	-
ONE Crna Gora DOO Podgorica	2,319	-
4iG Albánia Korlátolt Felelőss	-	-
Total	**83,367**	**75,358**

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Blerjet gjatë vitit të mbyllur më 30 qershor 2022 dhe 30 qershor 2021 detajohen si më poshtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	-	155,522
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	86,985
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	2,942
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	-	3,433
Banka Kombetare Tregtare Kosovo Sh.A	-	9,209
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş	-	-
Akılcı Bilişim Çözümleri ve Da	-	-
CETEL TELEKOM ILETISIM A.S	-	6,893
Çalık Holding AŞ	-	27,138
Çalık Holding AŞ	-	99,148
Çalık Holding AŞ	-	4,845
Posta Shqiptare	1,816	1,752
ONE TELECOMMUNICATIONS	69,385	-
ONE Crna Gora DOO Podgorica	1,349	-
4iG Albánia Korlátolt Felelőss	183,038	-
Total	**255,588**	**397,867**

Shpërblimet e drejtorëve të përfshira në shpenzimet e Shoqërisë për vitin janë si më poshtë:

	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2022	Për periudhen e mbyllur me 30 qershor 2021
Paga, shpërblime të organeve drejtuese	49,163	108,977
Paga, shpërblime të anetareve te bordit mbikqyres	8,594	19,174
Total	**57,757**	**128,151**

26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Që nga data 30 qershor 2022, data e këtyre pasqyrave financiare dhe deri në datën e miratimit të tyre nuk ka ndodhur asnjë ngjarje tjetër pasuese që të jetë materialisht e rëndësishme për t'u paraqitur në pasqyrat financiare.